



BASHKIA BERAT

Analiza e Aktivitetit Ekonomiko-Financiar të Vitit 2015 dhe Plan Buxheti i Vitit 2016



VIZIONI

BERATI I LASHTË, QYTET I TRASHËGIMISË KULTURORE BOTËRORE, ME NJË KOMUNITET QË I GËZOHET ZHVILLIMEVE HARMONIKE DHE MUNDËSIVE TË BARABARTA, NJË QENDËR E TURIZMIT NDËRKOMBËTAR, ME EKONOMI DINAMIKE TË MBËSHTETUR NË AGROBIZNES DHE ARTIZANAT TË KONSOLIDUAR.

MISIONI

OFRIMI I SHERBIMEVE PUBLIKE QYTETAREVE DHE PERDORIMI ME DOBI , FRYTSHMERI DHE TRANSPARENCE TE FINANCEVE VENDORE ,NE PERPUTHJE ME PROGRAMIN E ZHVILLIMIT VENDOR, RAJONAL SI DHE PRIORITETE E QEVERISE DHE STRATEGJISE KOMBETARE PER ZHVILLIM DHE INTEGRIM.



PERMBAJTJA

MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2016

KAPITULLI I

ANALIZA E REALIZIMIT TE TREGUESVE TE BUXHETIT TE VITIT 2015

- A. Informacion i pergjithshem
- B. Struktura financiare buxhetore e vitit 2015.....
- C. Zhvillimet fiskale gjatë vitit 2015.....
- D. Analiza e realizimit te planit te te ardhurave.....
- E. Analiza e realizimit te planit te shpenzimeve korrente.....
- F. Analiza e shpenzimeve sipas programeve buxhetore.....
- G. Investimet publike
- H. Auditimi- instrument I rendesishem per zbatimin e ligjshmerise.....

KAPITULLI II

PLAN BUXHETI I VITIT 2016

Informacion i permbledhur plan buxhetit te vitit 2016

- 1. Të ardhura nga burime kombetare.....
 - 1.1 Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.....
 - 1.2 Transferta të Kushtëzuara nga Buxheti i Shtetit.....
 - 1.3 Fondet për zhvillimin e rajoneve.
- 2. **Te ardhurat e pushtetit lokal**
- 3. Plani i shpenzimeve ;
 - 3.1 Plan i shpenzimeve per njesite shpenzuese.....
 - 3.2 Perdorimi i teprices neto operative per investime.....
 - 3.3 Alokimi I fondeve sipas programeve.....



MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT, Z. PETRIT SINAJ PËR BUXHETIN E VITIT 2016

E nderuara Kryetare e Këshillit, Znj. Nikoleta Manka.

Të nderuar këshilltarë të Bashkisë Berat.

Më lejoni t'ju uroj së pari Gëzuar Festat dhe një vit më të mbarë dhe më të suksesshëm për ju, familjet tuaja por edhe për bashkinë tonë.

Ky projekt-buxhet që ju është prezantuar është i pari pas reformës territoriale. Si i tillë ka pikat e forta dhe të dobëta të tij.

Nuk është më i miri dhe më i ploti që do të donim ne të kishim por është buxheti i risive dhe sfidave për të sjellë më shumë shërbime cilësore dhe investime konkrete për të gjithë qytetarët.

Më poshtë po ju bëj një përmbledhje. Idetë, shpërndarja dhe mënyra e organizimit të projekt-buxhetit është bërë pasi janë organizuar mbi 20 dëgjesa publike me grupe të ndryshme interesi në të gjithë territorin e bashkisë sonë.

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë Berat për vitin 2016 është në nivelin 219 580.000 lekë. Përveç kësaj kemi edhe transfertën e specifike që është 213 041 000 lekë dhe në total kemi mbi 432 621 000 lekë.

Transferta për vitin 2016 ndahet sipas një formule të re e cila bazohet në të dhënat e popullsisë, dendësinë e popullsisë dhe numrit të nxënësve në shkolla. Në formulë parashikohet një harmonizim i të dhënave të popullsisë sipas Census-it dhe Gjendjes Civile, si dhe një ekualizim fiskal duke kompensuar njësitë me dendësi të popullsisë dhe kapacitet fiskal më të ulët.

1. Pikë e fortë është detyrimi i bashkive për të përdorur jo më pak se 40 % të transfertës së pakushtëzuar për investime. Kusht ky që vendoset për herë të parë. Pra kemi afërsisht 88 milionë lekë investime nga ky kushtëzim.

2. Pikë tjetër, në lidhje me paketën fiskale të vitit 2016, janë ndryshimet e rëndësishme që lidhen me taksën e pasurisë, ku Qeveria vendosi taksën mbi truallin (jo-hapësirë publike) dhe detyrimin për përdoruesin e pasurisë së paluajtshme për të vetë deklaruar sipërfaqen e pasurisë dhe për të paguar taksën. Kjo do të kontrollohet me hipotekën dhe kadastrën për saktësimin e deklarimit.

3. Ndërkohë, një tjetër ndryshim lidhet me përjashtimin nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i bizneseve të vogla me qarkullim vjetor 0-5 milionë lekë dhe uljen e shkallës tatimore nga 7,5 % në 5 % të këtij tatimi për ato me qarkullim vjetor 5-8 milion lekë. Efekti financiar i kësaj politike vlerësohet në **rreth 50 milionë lekë më pak** për të ardhurat e bashkisë Berat.



Përsa i përket funksioneve të reja që na transferohen në janar, ato do të financohen nëpërmjet transfertave specifike për çdo funksion .

1. PAKETA FISKALE DHE BUXHETET VENDORE

Në të ardhurat e veta të pushtetit vendor peshën kryesore do e zënë të ardhurat nga taksat vendore por edhe të ardhurat nga tarifat do të jenë një burim i rëndësishëm i të ardhurave.

Të ardhurat shitesë vlerësohen të gjenerohen kryesisht nga përmirësimi i administrimit të të ardhurave të veta, si rezultat i menaxhimit dhe strukturës së re, në përputhje me Reformën Administrative e Territoriale.

Në taksat e tarifat vendore për vitin 2016, fokusi do të jetë Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme.

Në Paketën Fiskale 2016 janë shtesat dhe ndryshimet ligjore të cilat synojnë rregullimin e një sërë problematikave të hasura gjatë procesit të administrimit të taksës së pasurisë, ku ndër më të rëndësishmet përmendim:

- a) Taksimi i truallit (jo hapësirë publike).
- b) Detyrimi i përdoruesit të pasurisë së paluajtshme për pagesën e taksës.
- c) Detyrimi i përdoruesit të pasurisë së paluajtshme për të vetë deklaruar sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme për efekte të taksimit.

Përsa i përket të ardhurave nga taksat e tarifat e tjera vendore, në paketën fiskale për 2016, ato janë vlerësuar me një rritje prej rreth 30,9% në krahasim me pritshmërinë e vitit 2015 ku burimi kryesor i rritjes pritet të jetë mirë administrimi. **Pra përgjegjësi direkte për administratën.**

Sikurse evidentuar më sipër, Qeveria parashikon një rritje të të ardhurave nga taksat vendore, kryesisht me burim mirë administrimin që pritet të derivojë nga konsolidimi territorial dhe menaxhimi i ri i bashkive. Gjithsesi, vlen të theksohet se ndërkohë që konsolidimi territorial do të sjellë përmirësime, kapacitetet fiskale të njësive administrative vazhdojnë të mbeten të ulëta në raport me detyrimet e bashkisë për t'u ofruar qytetarëve të këtyre njësive, akses në shërbime të një cilësie pranueshmërisht të njëjtë me ato që ofrohen për rezidentët e zonave urbane.

2. FUNKSIONET E REJA

Bazuar në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili do të hyjë në fuqi në 1 janar 2016, qeverisjes vendore, pra bashkisë i transferohen disa funksione dhe përgjegjësi të reja për shërbime të rëndësishme publike, të cilat mund të kenë një impakt të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik vendor. Gjithsesi, suksesi në ushtrimin me efektivitet të këtyre funksioneve është pandashmërisht i lidhur me nivelin e financimit që do të ofrohet nga qeveria. Në ligjin “Për vetëqeverisjen vendore”, është parashikuar një dispozitë tranzitore e cila sanksionon se funksionet e reja do të financohen nga qeveria qendrore me transferta specifike për çdo funksion dhe çdo njësi përfutuese të fondeve. Kjo



skemë financimi do të përdoret për një periudhë tre vjeçare, deri në hartimin e një skeme të qëndrueshme financimi e cila të reflektojë nevojat për shpenzime dhe investime për secilin funksion.

Bashkia do të marrë fonde për :

1. Qendrat e shërbimeve sociale;
2. Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;
3. Personelin mësimor dhe jo-mësimor në arsimin parashkollor;
4. Personelin jo-mësimor në arsimin parauniversitar;
5. Konviktet e arsimit parauniversitar;
6. Rrugët rurale
7. Administrimin e shërbimit pyjor.
8. Bordin kullimit.

Këto transferta specifike përfshijnë fondet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, shpenzime operative dhe ato për investime.

Në të njëjtën kohë, për të gjitha funksionet e sipërcituara, Ministrinë e linjës, Qarqet dhe institucionet e tjera qendrore janë të ngarkuara që para fillimit të vitit fiskal, pra brenda dhjetorit 2015, të transferojnë tek Bashkitë të gjithë dokumentacionin përkatës për kuadrin ligjor që rregullon ushtrimin e funksioneve, personelin, mjetet, asetet dhe të dhëna të tjera të nevojshme për ushtrimin efektiv të funksioneve.

Ndërkohë, duhet të specifikohet se ende nuk janë përcaktuar fondet që do t'u transferohen bashkive për ushtrimin e dy nga funksionet e reja, më specifikisht për administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe drejtoritë e bujqësisë. Në nenin 15 të projektligjit për buxhetin e vitit 2016, ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda muajit janar 2016, të bëjë transferimin e fondeve për numrin e punonjësve nga programet e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek Bashkitë. Gjithashtu, për nevojat për investime në sektorin e ujitjes dhe kullimit, Qeveria ka përcaktuar një fond prej rreth 2.5 miliardë lekë, i cili gjithashtu do të alokohet nga Këshilli i Ministrave. Lidhur me këto dy funksione, sidomos për investimet për me ujitjen dhe kullimin mbeten ende të paqarta kriteret dhe afatet kohore që do të përdoren për ndarjen e këtyre fondeve ndërmjet njësive vendore. Duke qenë se fondi prej 2.5 miliard lekë nuk është pjesë e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve shpresohet që Këshilli i Ministrave të publikojë sa më shpejt kriteret dhe procedurat nëpërmjet të cilave do të ndahen këto fonde, për një funksion i cili historikisht ka qenë i nën-financuar.



Përtej pikëpyetjeve që shoqërojnë funksionet e bujqësisë, ujitjes dhe kullimit, për qeverinë ende mbetet një detyrë e rëndësishme përcaktimi i një skeme të qëndrueshme financimi, që kalon periudhën tranzitore 3-vjeçare të përcaktuar në projekt-ligjin për vetëqeverisjen vendore. Projekti i Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore është duke përfunduar një raport fillestar mbi funksionet e reja që janë transferuar tek njësitë e qeverisjes vendore. Ky raport do të përmbajë informacion mbi organizimin dhe funksionimin e funksioneve dhe një vlerësim të kostove të tyre financiare. Sigurisht ky është vetëm një draft fillestar i cili pritët të publikohet brenda dhjetorit 2015, dhe ndërkohë që do të përmirësohet , pritët të shërbejë si një hap i parë për veprime të tjera. Një ndër këto veprime është bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe donatorë të tjerë për të kryer një monitorim të implementimit të këtyre funksioneve të reja dhe përcaktimi i nevojave reale për shpenzime dhe sidomos investime, duke kontribuar kështu për ndërtimin e një skeme të qëndrueshme financimi për funksionet e reja.

3. FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Ndryshimet që sjell buxheti 2016 për Fondin e Zhvillimit të Rajoneve janë:

1. Një program të ri financimesh në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë vendore dhe rajonale nëpërmjet mbështetjes së sipërmarrjeve të reja (start up) dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
2. Vazhdimi i financimit të programit të prezantuar në vitin 2015, “Shqipëria Dixhitale” i përbërë nga grante konkurruese për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit.
3. Krijimi i Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Rajoneve, dhe katër Agjencive për Zhvillimin e Rajoneve.
4. Mundësia e financimit të skemave të granteve me përfitues individë dhe subjekte private për aplikimet në shtyllat e Mbështetjes së Ekonomisë dhe “Shqipëria Dixhitale”.

Në përfundim, për vitin 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga tre shtylla kryesore:

Shtylla I : Programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale vendore. Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale. Granti për arsimin dhe sportin . Granti për shëndetësinë . Granti për artin dhe kulturën. Granti për ujësjellës-kanalizime. Granti për rehabilitimin mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin

Shtylla II : Programi i mbështetjes së ekonomisë . Nën-programi i financimit të pjesëmarrjes në shoqëri tregtare dhe instrumenta të financimit për bizneset start-up; . Nën-programi i mbështetjes financiare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NMV-të)

Shtylla III : Programi Shqipëria dixhitale . Granti konkurrues për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit.

Në të treja shtyllat Bashkia Berat ka projekte për të aplikuar dhe ka aplikuar tek FZSH dhe FZH Rajoneve.



Ne bashkë financim me FZSHH do hartojmë 5 projekte te reja gjate 2016 si :

- Rikualifikim dhe rikonstrukcion i sheshit agjensia (harmonia fetare) dhe fasadat e lagjes aty
- Rikualifikim dhe rikonstrukcion i rrugës “Muzak Topia”
- Rikualifikim i Fasadave përgjatë gjithë rrugës “Antipatrea”
- Rikualifikim dhe rikonstrukcion i rrugës “Agron Elezi”

4. PROJEKTET E TJERA

a) Kanë kaluar fazën përfundimtare dhe presin financim gjatë 3-mujorit të parë :

1. K.U.Z fshati Lapardha në vlerë mbi 90 milionë lekë.
2. K.U.Z fshati Mbreshtan në vlerë mbi 60 milionë lekë.
3. Është në tenderim vazhdimi i pedonales nga sheshi kryesor deri tek stadiumi i vjetër me vlerë mbi 160 milionë lekë.
4. Rruga Stadiumi i vjetër - Stadiumi i ri me vlerë 400 milionë lekë.
5. Parmakët, ndriçimi dhe riveshja e rrugës Ura e varur - Ura e Goricës me vlerë mbi 60 milionë lekë.

b) Mbi 10 projekte janë në diskutime në sekretariatet teknike të institucioneve. Si shkolla, kopshte, qendra shëndetësore dhe rikualifikime rrugë lagjesh dhe lulishte, kjo edhe sipas propozimeve nga komisionet apo dhe nga dëgjesat publike.

c) Me Ipat-Stategjike po hartohen projekte për parkun kombëtar të Tomorrit dhe rruga që të con aty. Për zonën e mbrojtur të qytetit si lagjet Goricë, Kala dhe Mangalem etj... Për tregun e shitjes me shumicë fruta – perime në Moravë etj.

d) Me USAID, po hartohet plani i përgjithshëm rregullues i Bashkisë Berat, i cili përfundon në dhjetor 2016.

e) Me ministrinë e Zhvillimi kemi në diskutimet e fundit dy projekte, për pjesën fundore të lagjes Pjeshkorja dhe riparim ndërtesash të komunitet rom.

f) Me AADF po negociojmë për projektin e radhës për lagjen Kala dhe Goricë.

g) Projekti me borxhin Italian ka të bëjë me ndërthurjen e turizmit historiko-kulturor, agro-turizmit dhe iniciativës.



h) Me ndërmarrjet e varësisë kemi kthyer dhe po kthejmë në funksion të qytetarëve mijëra metra katrorë ndërtime të paligjshme, apo edhe zaptime të pronës publike në lulishte, kënde lojërash etj. në çdo lagje të bashkisë. Ky aksion vazhdon...!

5. PROJEKTET E TJERA ME DONATORE

Do punohet për të aplikuar për çdo thirrje për projekte nga partnerët e huaj dhe do vazhdojmë me intensitet kontaktet dhe bashkëpunimin me :

Bashkitë Binjake

Rrjetet Ndërkombëtare

Organizatat dhe donatorë

Bashkëfinancimet

Projektet e BE .

Po vijohet puna për te aplikuar për projekte me donatore për vitin në vijim:

- Thirrjet e reja IPA të Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë :
 - a- Programi *Adrion*
 - b- Programi Ndërkufitar Shqiperi- Greqi
 - c- Programi i Mesdheut
 - d- Programi *Erasmus*
- Banka Botërore në Shqipëri
- Programi i Borxhit Italian
- Agjensia e Zhvillimit Gjerman *GIZ* (Projekte në fushën e energjisë së rinovueshme dhe turizmit) .
- Zyra e *Kooperimit Zvicerian*- Strategjia e asistencës për Shqipërinë 2014-2017.
- Projekte të përbashketa me bashkitë binjake dhe rrjetet ndërkombëtare.
- Vijn puna me partnerët strategjikë : *AADF*, *USAID* , *PNUD*.
- Bashkëfinancimi i eventeve dhe festave në qytetit me donatorë të huaj.
- Koordinim me *Shoqatën Europiane të Qyteteve të Artit dhe Historisë* për projekte në fushën e planifikimit urban dhe trashëgimisë kulturore.
- Rritja e kapaciteteve e stafit të Bashkisë nëpërmjet projektit *DLDP* financiar nga *Kooperimi Zvicerian*.

Të nderuar këshilltarë !

Ju ftoj ta votojme kete projekt-buxhet, per ti hapur rruge realizimit te angazhimeve, per te bere me te miren e mundshme, brenda te gjitha mundesive ligjore financiare , ne dobi te plotesimit te objektivave dhe prioriteteve, dhe per ti ofruar sherbim cilesor cdo qytetari ne cdo cep te bashkise.

Gjithashtu Ju falenderoj per mbeshtetjen e deritanishme, bashkepunimin e frytshem, angazhimin qe keni treguar, diskutimet konstuktive qe keni bere ne cdo mbjedhje keshilli apo komisioni, si dhe



BASHKIA BERAT

vendimarrjet e rendesishme, qe kane ndihmuar administraten e bashkise ne realizimin e detyrave dhe funksioneve ligjore!

Realizimi i treguesve te ketij buxheti eshte sfida qe kemi perpara. Jam i bindur dhe shprese plote ne mbeshtetjen tuaj te vazhdueshme, ne realizimin e kesaj sfide te perbashket, per te permiresuar cilesine e jetes se banoreve te bashkise tone!

Mirenjohes per pune tuaj te deritanishme dhe ne vazhdim !

Me respekt,

Petrit SINAJ

KRYETAR I BASHKISE

.



ANALIZA E REALIZIMIT TE TREGUESVE TE BUXHETIT TE VITIT 2015

Informacion i pergjithshem i buxhetit te vitit 2015.....

Viti 2015 shënon një ndryshim historik për qeverisjen vendore, pasi do të zbatohet reforma e re territoriale dhe administrative dhe do të zhvillohen zgjedhjet e reja vendore. Bashkia e Beratit zgjerohet si territor duke u kthyer në një qendër të rëndësishme funksionale zhvillimi së bashku me Komunitetin Sinjë, Velabisht, Otlak dhe Roshnik.

Harta territoriale, sipërfaqja e njësive të re dhe popullsia është si më poshtë :

1. Qyteti Berat me Sipërfaqe 23 km² dhe popullsi 63'022 banorë
2. Komuna Velabisht me Sip 930 km² dhe popullsi 11'663 banorë. Ka 11 fshatra
3. Komuna Sinjë me Sip 1463 km² dhe popullsi 5'473 banorë. Ka 14 fshatra
4. Komuna Otlak me Sip 632 km² dhe popullsi 14'043 banorë. Ka 14 fshatra
5. Komuna Roshnik me Sip 818 km² dhe popullsi 3'961 banorë. Ka 13 fshatra.

Bashkia Berat do të ketë Sip 3,866 km² dhe popullsi 98,162 banorë dhe në përbërje do të jetë qyteti i Beratit me 48 fshatrat e Komunave të mësipërme. Zbatimi i reformës së re administrativo-territoriale do të kursojë buxhetit të shtetit rreth 6 miliard lekë shpenzime administrative si dhe do të çlirojë shumë fonde publike në favor të zhvillimit ekonomik lokal, duke eliminuar pabarazinë midis zonave më potencialë zhvillimi dhe atyre që rezultojnë si zona të varfëra.

- ✓ Ndarja e re administrative është sfidë e rëndësishme. Ajo do të shoqërohet me reforma të tjera dhe një paketë ligjore që demokratizon dhe rrit efikasitetin e qeverisjes, përmirëson kualitetin e administratës vendore dhe garanton mbulimin me cilësi shërbimesh në gjithë territorin e njësive të re administrative.
- ✓ Zgjedhjet vendore të vitit 2015, shënuan fillimin e qeverisjes vendore sipas ndarjes së re administrativo-territoriale.
- ✓ Ndarja e re administrativo-territoriale, do të pasohet nga një reformë tjetër e decentralizimit fiskal. Me këto reforma synohet:
 - (i) demokratizimi i qeverisjes;
 - (ii) efienca në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
 - (iii) zhvillimi ekonomik lokal,
 - (iv) zhdukja e pabarazive dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
- Nga pikepamja e ekonomike-financiare viti 2015 shënoi rritjen e **Buxhetit vendor në tërësi**. Nëse në vitin 2012 buxheti vendor zinte 2.1% të PBB-se, në vitin 2013, 2%, në vitin 2014, 2.4% të PBB, dhe në vitin 2015, 2.7% të PBB (sipas Ligjit “Per miratimin e buxhetit të Vitit 2015, nr.160/2014)



BASHKIA BERAT

- Jane bërë pëmirësime në shpërndarjen e **Transfertes se pakushtezuar** per Njesite e Qeverisjes vendore dhe **ka rritje te saj** . Bashkia Berat perfiton nga transferta 206 leke, pra, shtesa e transfertes ne vlere absolute ne krahasim me vitin 2014.
- Efektet e **paketes fiskale** dhane efekt pozitiv ne buxhetin e vitit 2015, duke rritur % e mbulimit te kostos me tarifat.
- Per evidentimin e **borxhit e të detyrimeve** te prapambetura Ministria e Financave ka ndjekur një proces intensive te evidentimit, vleresimit dhe auditimit te borxhit. Ne kete konteks ne kemi kryer procedurat ne perputhje me kete orientim.
- Bashkia Berat **fillon vitin buxhetor 2015 pa detyrime te mbartura** (me perjashtim te faturave te muajit dhjetor),ne ndryshim nga viti 2014 ne te cilin mbarti detyrime nga viti 2013 ne shumen 68.2 milion leke, nga te cilat 30.8 milion leke ishin investime te perfundura dhe te pafinancuara sipas plan buxheti te vitit 2013.
- **Permiresimin e strukture se shpenzimeve kapitale** ndaj totalit te shpenzimeve . Ne buxhetin e vitit 2014 investimet nga te ardhurat zene rreth **17%** te totalit te shpenzimeve.
- **Zbatimi i proçedurave te prokurimit elektronik edhe per blerjet e vogla**, ne mbeshtetje te Udhhezimit nr. 7 date 20.12.2012 “Per zhvillimin e prokurimeve me vlere te vogel ne sistemin elektronik per autoritet kontraktore dhe operatoret ekonomik” si dhe VKM nr. 47 date 23.01.2013 “Per nje shtese ne VKM nr.45 date 21.01.2009 “Per kryerjen e proçedurave te prokurimit publik ne menyre elektronike” ,te ndyshuar. Kjo menyre eshte menyra **me transparente e prokurimit**.
- Ligji nr.48/2014 “Per pagesat e vonuara ne detyrimet kontraktore” ,(i cili kushtezon kryerjen e pagesave brenda 30 diteve), pjese e strategjise se Ministrise se Financave per **parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve te prapambetura**, ka dhene efektin pozitiv ne parandalimin e rikrijimit te debive.
- Bashkia Berat duke filluar nga **viti 2014 kemi shlyerjen e kestit te pare te kredise CEB** per ndertimin e banesave sociale me qera, e cila vijoj edhe ne vitin 2015, sipas dispozitave ne fuqi.
- Bashkia Berat mbyll vitin buxhetor 2014 dhe 2015 **pa detyrime dhe borxhe te mbartuara**, qe do te thote nje permbyesje e **mosballancimit buxhetor** te ndodhur ne vitet e fundit.
 Viti 2011 u mbyll ne deficitin buxhetor prej 51.9 milion leke.
 Viti 2012 u mbyll ne deficitin buxhetor prej 49.5 milion leke.
 Viti 2013 u mbyll ne deficitin buxhetor prej 68.2 milion leke.
 Viti 2014 u mbyll ne deficitin buxhetor prej 12,4 milion leke (investim i mbetur nga A.L.U.I.Z.N.I)
 Viti 2015 mbyllet pa deficit buxhetor (me përjashtim te faturave te muajit dhjetor).

Buxheti i vitit 2015 garanton kalimin efektiv të kompetencave, përgjegjësi dhe të gjithë problematikave vendore nga të zgjedhurit aktualë tek të zgjedhurit e rinj, ku janë parashikuar masat e nevojshme, rolet dhe detyrat përkatëse të periudhës tranzitore.



BASHKIA BERAT

Në këtë kuptim, buxheti 2015, garanton ekuilibrat financiarë dhe aktivitetin normal të funksioneve të bashkisë. Ndonëse miratohet si një buxhet vjetor, ky buxhet rishikohet pas zgjedhjeve vendore dhe njësisë së re administrative.

Bashkia Berat në këtë proces transformues do të jetë Bashki pilot nën monitorimin e USAID, dhe të projektit STAR, që do të lehtësojë kapërcimin e vështirësive të kësaj reforme.

Në u angazhuam dhe ushtruam gjithë vullnetin dhe përgjegjësitë tona për mbarrvajtjen e këtij procesi dhe garantuam një vitë buxhetor dinamik, me shërbime cilësore, me financa solide dhe me investime publike shumë herë se cdo vitë tjetër.

Për vitin 2015, buxheti për Bashkinë Berat është 206 milionë lekë nga transferta e pakushtëzuar që ka një rritje 5% në krahasim me vitin 2014.

Për të dytin vit radhazi, Qeveria akordon një fond ekselent prej 5 milionë lekë grand për statusin e Beratit në UNESCO.

Në transfertën e pakushtëzuar janë vendosur kriterë dhe tavane që ruajnë ekuilibrat e shpenzimeve duke kufizuar shpenzimet për pagat nga 15% që ishte në vitin 2014 në 10% në vitin 2015 dhe duke i dhënë përparësi rritjes së trendit të investimeve.

Buxheti 2015 parashikon që të ardhurat vendore të jenë të rritura 18,5% më të larta se viti 2014 dhe paketa fiskale nuk parashikon ndryshime në sistemin aktual të taksavë vendore.

Edhe këtë vit jemi të kufizuar dhe të bllokuar nga ligji për lejet zhvillimore dhe paketës falas të legalizimeve, çka do të sjellë të ardhura të munguara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë që zë një pëdhënë të ndjeshme në buxhet.

Për vitin 2015 të ardhurat vendore parashikohen të planifikohen 227 milion lekë. Duke respektuar ligjin e buxhetit dhe përmbushjen e detyrimeve dhe funksioneve që kryen bashkia, për vitin 2015 kemi në dispozicion një tepriçë neto operative për rreth 74.4 milionë lekë, e cila do të përdoret për bashkfinancime, investime publike dhe shpenzime në funksion të rritjes së cilësisë urbane, të shërbimeve publike, dhe për plotësimin e standarteve në arsim, në shëndetësi, turizëm, çështjet mjedisore etj.

Bashkimi mekanik i buxheteve të ish-komunave me Bashkisë Berat.

Bazuar edhe në udhëzimin e Agjencisë për Zbatimin e Reformës Territoriale si dhe të Ministrisë së Financave, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar të Bashkisë dhe sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të Institucionit dhe të shërbimeve ndaj qytetarëve, paraqitem bashkimin mekanik të buxhetit të bashkisë Berat, në Keshillin Bashkiak, si buxhet tranzit të Bashkisë, që pas miratimit nga KB me vendimin nr. 12 datë 04.08.2015 dhe konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1438/1 datë 07.08.2015, u depozitua pranë degës së Thesarit, sigurojë vazhdimin e veprimtarisë financiare të Bashkisë.

Për shkak të lidhjes organike ndërmjet strukturës organizative, paketës fiskale dhe buxhetit, miratimi i paketës fiskale në ato nivele të ish-komunave, u harmonizua me miratimin e buxhetit të Bashkisë së re si bashkim mekanik i buxheteve të ish-njësive përbërëse.



BASHKIA BERAT

Buxhet do të mund të sigurojë balancën e nevojshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve si dhe sigurimin e vazhdimësisë së financimit të shpenzimeve administrative, operative dhe të kontratave të shërbimeve dhe investimeve të lidhura midis ish njësive që janë shkruar dhe subjekteve private.

Disa tregues të Buxhetit tranzit:

- 35% e buxhetit në total ose 179 761 000 leke e përbejnë pagat dhe sigurimet shoqërore të gjithë punonjësve të bashkisë, njësive të vartësisë dhe njësive administrative.
- Pagat dhe sigurimet shoqërore të administratës së bashkisë përbejnë 19% të buxhetit në total ose zënë 59 394 000 leke.
- 23% e buxhetit në total ose 63 048 000 leke e përbejnë shpenzimet për investime.
- 42 % buxhetit në total e përbejnë shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

Me miratimin e Vendimit Nr. 09 date 04.08.2015 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e numrit të punonjësve, institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative", miratuar me shkresën Nr. 1420/1 Prot. Date 05.08.2015 të Prefekturës Berat si edhe të Vendimeve perkatese të Kryetarit, u formatua struktura organizative e Bashkisë Berat, që siguroi vazhdimësinë e ushtrimit të funksioneve ligjore në shërbim të komunitetit.

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 664 date 29.07.2015 "Për shpërndarjen e fondit tranzitor për zbatimin e reformës territoriale", Bashkisë Berat i është akorduar fondi prej 29 484 200 lekë. Fondi i mesipër i cili rrit buxhetin e Bashkisë Berat u miratua të përdoret sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 11 date 21.08.2015.

Trashegojme nga njësitet administrative këto situata financiare, e cila u bë pjesë e situatës financiare të bashkisë Berat:

1. Nj. Administrative Velabisht të ardhura të trashëguara 5 047 000 leke,
2. Nj. Administrative Sinjë të ardhura të trashëguara 4 090 000 leke,
3. Nj. Administrative Otlak të ardhura të trashëguara 9 708 000 leke,
4. Nj. Administrative Roshnik të ardhura të trashëguara 1 614 000 leke,



BASHKIA BERAT

ZHVILLIMET FISKALE GJATË VITIT 2015

➤ *Rritja e të ardhurave*

Viti 2015 shënon vitin me realizimin më të mirë të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore. Rritje kanë pasur të ardhurat nga taksat dhe nga tarifat vendore, niveli i arkëtimit të të cilave, gjithashtu është mirë i miri i viteve të mëparshëm. Ndikim kanë dhënë sigurisht edhe të ardhurat e realizuara nga njësitë administrative që i janë bashkuar Bashkisë Berat.

➤ Në hartimin e paketës fiskale, dhe në tërësi të buxhetit vendor 2015 **jemi asistuar nga specialist të USAID-it**, pasi Bashkia Berat është Bashki pilot e përzgjedhur që në vitin 2013.

➤ **Është viti i tretë i faturimit të tarifave të familjes së bashku me faturën e ujit të pijshëm**, dhe vjelja nga Ndërmarrja e Ujësjellës –Kanalizimeve. Rezultatet e kësaj mënyre janë pozitive në rritjen e të ardhurave. Pavarësisht faktit që është rritur baza e tatushme, ka vënd për saktësimin e listave të familjeve (klientëve të ujësjellësit, dhe familjeve sipas rregjistrimit të Gjëndjes Civile.). Gjithashtu shpërndarja e pagesës me këste e këtyre detyrimeve, gjatë 12 muajve të vitit, lehtësoi pagesën e detyrimeve për familjarët.

➤ **Pezullimi i dhënies së lejeve të ndërtimit** për qytetin e Beratit, në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 08.10.2013 çoi në mosrealizimin e të ardhurave nga ky burim shumë i rëndësishëm për financat vendore.

➤ **Përmirësimi i kapaciteteve për planifikimin** më të mirë të të ardhurave në kuadër të Programit Për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore (PLGP), një program 5 vjecar i financuar nga USAID në të cilën Bashkia Berat është përzgjedhur si pjesë e programit nga një numër prej rreth 30 njësisht kandidatë. Në këtë drejtim u krye informatizimi i sistemit të taksave dhe tarifave vendore (për biznesin) dhe për financën. Përkatesisht u ndërtuan sistemet TAIS dhe FAIS. Sistemi TAIS është vënë plotësisht në punë për pjesën e biznesit.

STRUKTURA FINANCIARE E BUXHETIT TE VITIT 2015

Te dhenat ne 000 leke


Nr.	Emertimi	Plan Buxheti	Buxheti I korrigjuar	Fakti	Pesha spec. ndaj tot. ne %	Realizimi ne %
1	Transferta e pakushtezuar	206,111	235,595	235,595	43	100
2	Te ardhurat lokale	227,000	269,150	239,149	49	89
3	Te ardhura te trasheguara	21,534	41,993	41,993	8	100
I	Totali i te ardhurave	454,645	546,738	516,737	100	93
1	Shpenzime personeli		194,300	179,761	35	92
2	Shpenzime Operative		229,082	195,961	42	89
A	Shuma e shpenz. Korrente		423,382	375,934	78	91
B	Investime (TNO)		123,356	63,048	23	51
II	Totali i Shpenzimeve	462,005	546,738	438,770	100	80




Grafiku nr. 1

Struktura financiare e buxhetit te vitit 2015

Te ardhurat



Shpenzimet



Nga te dhenat e pasqyres se mesiperme rezultojne keta tregues:

- Transferta e pakushtezuar ne total perben 43 % te totalit te te ardhurave gjithesej kundrejt 45% ne vitin 2014 dhe 2013
- Te ardhurat lokale perbejne 49% te totalit te te ardhurave gjithesej kundrejt 46% te totalit te te ardhurave ne vitin 2014 dhe 51% te totalit te te ardhurave ne vitin 2013.
- Te ardhurat e trashegueshme 8% te totalit te te ardhurave gjithesej, ashtu si dhe ne vitin 2014, kundrejt 4% te totalit te te ardhurave ne vitin 2013.
- Shpenzimet e personelit perbejne 35 % te totalit te shpenzimeve, kundrejt 37% te raportit ne vitin 2014
- Shpenzimet operative perbejne 42% te totalit te shpenzimeve kundrejt 47 % qe ky raport ka qene ne vitin 2014, 2013.
- Shpenzimet per investime nga te ardhurat perbejne 23 % te totalit te shpenzimeve kundrejt vleres prej 16% per vitin 2014 dhe 4.5 % ne vitin 2013.

Pra sic shihet dhe nga raportet kemi nje rritje ne perqindje per shpenzimet per investime.



BASHKIA BERAT

PLANI FINANCIAR I BASHKISE BERAT

Buxheti i Bashkise Berat u miratua me Vendimin e Keshillit te Bashkise Nr. 52 date 29.12.2014 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2015”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresen nr. 8/1 date 13.01.2015, dhe pas celjes se tij nga dega e thesarit filloj zbatimimi I tij .

Ne zbatim te Ligjit Nr. 115/2014 “Per ndarjen administrative-territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Shqiperi” si dhe VKM Nr. 510 date 10.06.201, eshte bere miratimi I treguesve te buxhetit **transit te Bashkise Berat** deri me 31.12.2015, miratuar me VKB Nr. 12 date 04.08.2015 konfirmuar ne Prefekture me shkresen Nr. 1438/1 date 07.08.2015 si dhe ne mbeshtetje te VKM Nr. 664 date 29.07.2015 eshte bere miratimi I perdorimit te fondit te akorduar Bashkise Berat me VKB Nr. 21 date 21.08.2015 konfirmuar ne Prefekture me shkresen Nr. 1479/1 date 27.08.2015 .

Ne mbeshtetje te ligjit nr.160/2014 date 27.11.2014 “Per buxhetin e vitit 2015”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te Buxhetit”, Bashkia Berat realizoi vitin buxhetor me keta tregues te miratuar :

ne 000 / leke.

A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....546,738

I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....311,143

- Te ardhura te trasheguara nga viti 2014.....21,534
- Te ardhura te trasheguara nga ish komunat.....20,459
- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2015).....269,150

II - Transferta gjithsej.....235,595

- Transferta e pa kushtezuar.....235,595

B - Shpenzimet gjithsej438,982

-Shpenzime operative.....375,934

-Shpenzime kapitale.....63,048

Gjate procedures se zbatimit te buxhetit, pas ndyshimeve te bera dhe transaksioneve financiare te ndodhura ne vitin 2015, dhe te vendimuara ne Keshillin Bashkiak, ne fund te vitit 2015 rezulton kjo situate financiare:

1. Transferta e pakushtezuar..... 235,595
2. Te ardhurat e vitit (fakt 11 mujor + I pritshem per muajin dhjetor)..... 239,149
4. Trasheguar nga viti 2014 ne vitin 2015..... 41,993

TOTALI I TE ARDHURAVE.....516,737



BASHKIA BERAT

Sipas natyres se shpenzimit, perdorimi i fondeve gjate vitit 2015, (realizimi I pritshem) ne menyre te permblendhur paraqitete si me poshte:

1. Shpenzime per pagat155,202
2. Shpenzime per sig.shoqerore dhe shendetesore..... 24,559
3. Shpenzime operative..... 195,961
4. Investime (nga te ardhurat lokale)..... 63,048

TOTALI I SHPENZIMEVE..438,770

Viti buxhetor 2015 i planifikuar i **balancuar**, pergjithesisht paraqitet me tregues pozitiv. **Trasheguam** nga viti 2014 te ardhura ne shumen totale **prej 21.533 milion** leke si dhe te ardhura te trasheguar nga ish komunat 20.459 milion leke pra ne total 41.992milion leke.

Duke qene se materiali eshte punuar gjate muajit dhjetor, ne baze te pritshmerise se realizimit te treguesve, e ardhura qe do te trashegohet nga vitit 2015 , e cila parashikohet te jete 25 000 000 leke do te rakordohet me degen e thesarit ne fillim te muajit janar 2016 dhe do te shperndahet si pjese e pagave dhe sigurimeve per aparatin e bashkise.

Transferta e pakushtëzuar dhe dinamika e saj

Transferta e pakushtezuar per vitin 2015 ne zbatim te .160/2014 date 27.11.2014 “Per buxhetin e vitit 2015” akordohet ne shumen **206 111 000** lek, 9 813 000 leke me shume se viti 2014 ose , 5% me e larte. Ne batim te VKM Nr. 664 date 29.07.2015 eshte alokuar fondi transit ne formen e grandit ne vleren 29 484 000 leke, pra ne total per vitin 2015 I eshte akorduar Bashkise Berat nje grand ne vleren **235 595 000 leke**.

Transferta e pakushtezuar per vitin 2013 ne zbatim te ligjit 119/2012 date 17.12.2012 “Per buxhetin e vitit 2013” eshte ne shumen 160 289 067 leke, ose 10% me e vogel ne indeks dhe 17 710 933 leke me pak ne vlere absolute se njoftimi i mare me shkresen e Ministrise se Financave nr. 18030 Prot. date 25.11.2012 “Dergohet per njoftim transferta e pakushtezuar per vitin 2013” ne zbatim te VKM nr.802 date 19.11.2011 “Per propozimin e projekt buxhetit te vitit 2013”. Transferta e pakushtezuar per vitin 2013 eshte **4%** me e ulet se transferta e korrigjuar e ne mes te vitit buxhetor (165 409 000 leke), ose **7%** me e vogel se transferta e fillimit te vitit 2012 (171 611 000 leke, miratuar me VKB nr. 3 date 01.02.2012). Ne tabelen me poshte jepet transferta e pakushtezuar ne vite.

Pasqyra nr. 1

Dinamika e transfertes se pakushtezuar ne vite

në /000 lekë


Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Transferta	135,678	160,580	159,898	165,450	165,409	162,289	196,298	235,595

Sipas anekseve perkatese te ligjit te buxhetit, edhe ne vitin 2015 vazhdon te mbulohet financiarisht Qendra “Lira” dhe funksioni i konvikteve.



Më qartë ecuria në vite e transfertës shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 2



ANALIZA E REALIZIMIT TE PLANIT TE TE ARDHURAVE

- Në total, për vitin 2015, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Berat përfshirë dhe njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak, priten të realizohen në shumën 239,149,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 269,150,000 lekë ose 89%.
- Në total kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 201,564,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 priten të realizohen me +37,585,000 lekë ose +19 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Pra përfshirja e njësive administrative në territorin e Bashkisë Berat ka dhënë efekte pozitive në të ardhura, megjithëse kontributi i tyre është i vogël krahasur me të ardhurat e grumbulluara nga bashkia qendër.

Është për tu theksuar fakti se 75-80% të të ardhurave totale janë realizuar nga bashkia qendër.

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave totale nga taksat dhe tarifat vendore sipas viteve.

Pasqyra nr. 2

në /000 lekë

Vitet	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhurat totale	143,276	159,710	225,715	181,877	186,240	167,986	186,426	200,002	239,149

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme shohim se viti 2015 përbën vitin më të mirë të realizimit të të ardhurave në këto 4 vitet e fundit. Natyrisht që ndikim të konsiderueshëm ka, sic e thamë edhe më lartë, përfshirja e njësive administrative në territorin e Bashkisë Berat.



**Grafiku nr. 3****Ecuria në vite e të ardhurave totale**

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi realizimin e të ardhurave të pritshme të vitit 2015 sipas grupeve kryesore.

Emërtimi	Të ardhurat në /000 lekë	Realizimi (në %)
Të ardhura nga taksa vendore mbi biznesin e vogël	45,856	113
Të ardhura nga taksat vendore	88,895	76
Të ardhura nga tarifat vendore	82,156	109
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	10,249	92
Të ardhura të tjera	11,015	59
Të ardhura nga legalizimet	985	15
TOTALI	239,149	89

Grafiku nr. 4**Realizimi i të ardhurave të pritshme të vitit 2015 sipas grupeve kryesore**

Nga të dhënat rezulton se peshën kryesore në të ardhurat e realizuara e zënë të ardhurat nga taksat vendore, kryesisht të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, taksa mbi ndërtesat, taksa e mjeteve të përdorura dhe të ardhurat nga zënia e hapsirave publike.



BASHKIA BERAT

Gjithashtu edhe të ardhurat nga tarifat vendore zënë një peshë shumë të konsiderueshme në totalin e të ardhurave të bashkisë.

Nga të dhënat e tabelës dhe nga grafiku i mësipërm vërehet se përgjithësisht të ardhurat janë realizuar në nivel të kënaqshëm.

Në mënyrë më të detajuar të ardhurat sipas grupeve kryesore dhe nën grupeve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme.

Pasqyra nr. 3

Të ardhurat e pritshme nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2015

në /000 lekë

Nr	Emertimi/Muaji	12 Mujori		
		Plani	Fakti	%
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	40,409	45,856	113
II	Taksat vendore	117,127	88,895	76
1	Takse tabelë	2,963	2,650	89
•	Tabelë për qëllime identifikimi	218	368	169
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,745	2,282	83
2	Ter ardhura nga zënia e hapsirave publike	15,934	14,652	92
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	20,000	8,090	40
4	Takse fjetje ne hotel	1,694	1,727	102
5	Takse mbi token bujqesore	14,733	5,101	35
6	Takse e mjeteve te perdorura	14,909	14,220	95
7	Takse e kalimit te se drejtes se pronesise pronësisë	3,000	1,655	55
8	Takse mbi ndertesat	42,838	40,415	94
•	Biznes	34,503	33,419	97
•	Familje	8,335	6,996	84
9	Takse therje	128	185	145
10	Te tjera taksa lokale	927	200	22
III	Tarifat vendore	75,241	82,156	109
1	Tarife e pastrimit	47,448	48,807	103
•	Biznes	30,907	32,394	105
•	Familje	16,541	16,413	99
2	Tarife e ndriçimit publik	11,933	13,331	112
•	Biznes	2,383	3,788	159
•	Familje	9,550	9,543	100
3	Tarife gjelberimi publik	4,846	5,155	106
•	Biznes	1,277	1,441	113
•	Familje	3,569	3,714	104
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,370	3,913	286
5	Tarifa urbanistike	300	322	107
6	Tarifa te sherbimit administrativ	1,610	2,042	127
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	1,118	1,903	170
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartelexuesi	275	-	-
9	Tarifa te sherbimit te varrimit	5,245	5,764	110
10	Tarife per lende drusore	1,095	919	84
IV	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	11,200	10,249	92
1	Te ardhura nga konviktet	1,000	1,173	117
2	Te ardhura nga cerdhet	3,500	3,092	88
3	Te ardhura nga kopshtet	6,700	5,984	89
V	Te ardhura te tjera	18,667	11,015	59
1	Te ardhura nga parkimi	1,116	1,389	124
2	Te ardhura nga qerate	7,205	5,242	73
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	3,845	3,948	103
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	1,000	254	25
5	Te ardhura nga biletat	200	30	15
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	5,301	152	3
VI	Te ardhura nga legalizimet	6,506	985	15
TOTALI		269,150	239,149	89



BASHKIA BERAT

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme shohim se plani vjetor i të ardhurave të vitit 2015 pritet të realizohet në masën 89 %, me një mosrealizim në shumën 30,000,000 lekë (se bashku me të ardhurat nga legalizimet).

Peshën më të madhe në këtë mosrealizim kryesisht e kanë 3 zëra të të ardhurave të cilët në total kanë një efekt në mosrealizimin e të ardhurave me rreth -27,063,000 lekë ose – 10. % të planit të të ardhurave totale të vitit 2015.

- **Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit dhe nga ndërtesat që janë në proces legalizimi.** si rezultat i ndryshimeve që i janë bërë ligjit për urbanistikën që reflektohet në bllokimin e dhënies së lejeve të ndërtimit dhe si rezultat i ecjes me hapa shumë të ngadaltë të procesit të legalizimit, ku një numër shumë i vogël dosjesh janë përpunuar si dhe kanë përfunduar procesin e legalizimit

Aktualisht ne të ardhurat nga lejet e ndërtimit jemi ne të njëjtat kushte sikurse gjatë viteve të fundit, me pothuajse asnjë leje ndërtimi të dhënë gjatë kësaj periudhe, si rezultat i pezullimit të dhënies së lejeve të ndërtimit për qytetin e Beratit, ne zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 08.10.2013 gjë që u reflektua në mosrealizimin e të ardhurave nga ky burim shumë i rëndësishëm për financat vendore.

Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga lejet e ndërtimit është rreth - 11,910,000 lekë.

Gjithashtu edhe **mos realizimi i të ardhurave të planifikuara nga legalizimet**, të ardhura të cilat mblihdhen nga A.L.U.I.Z.N.I. shtë në nivele shumë të ulëta në këto 5 vjet radhazi..

Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja që janë në proces legalizimi është rreth - 5,952,000 lekë. Të dy këto zëra kanë një efekt total -17,431,000 lekë.

- **Mos arkëtimi i të ardhurave të planifikuara nga taksa mbi tokën bujqësore**, të ardhura të cilat mblihdhen kryesisht nga Njësiti administrative. Të ardhurat nga ky zë, janë ndër burimet kryesore të të ardhurave nga këto njësi dhe natyrisht që duhet një punë e fortë në realizimin e këtyre të ardhurave. Efekti në të ardhurat e Bashkisë nga mosrealizimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore është rreth - 4,473,000 lekë.

Pasqyra nr. 4

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksa vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Taksa + Tatimi	52,334	41,667	55,309	53,640	49,740	51,892	45,839	41,649	34,615	45,856

Ndjekja e këtij tatimi i kaloi Drejtorive Rajonale Tatimore në rolin e agjentëve tatimorë, shërbim për të cilin përfitojnë 1% të vlerës së arkëtuar. Shihet se, realizimi i të ardhurave nga ky zë është më i ulët në raport me të ardhurat në vitet e mëparshme, kur këto të ardhura mblihdeshin nga Bashkia Berat. Madje



BASHKIA BERAT

në këtë drejtim janë bërë hapa pas, pasi edhe duke arkëtuar të ardhura nga një numër më i madh biznesesh (si rezultat i rritjes së numrit të bizneseve të regjistruar dhe përfshirjes së subjekteve të katër njësive administrative) të ardhurat e mbledhura nga agjenti tatimor nuk arrijnë dot të ardhurat kur ky tatim administrohej nga strukturat e bashkisë. Por megjithatë realizimi kundrejt planit është në nivele shumë të mirë.

Në total të ardhurat nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël :

- Për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 45,856,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 40,409,000 lekë ose 113 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 34,615,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 priten të realizohen me +11,241,000 lekë ose +33% më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Një efekt të konsiderueshëm ka fakti se subjektet kanë paguar në nivelin minimal të përcaktuar. Shumica e tatimpaguesve të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël i përkasin kategorisë së xhiros deri në 2 milion lekë. Shumë pak tatimpagues e kalojnë këtë prag.


Për vitin 2016 me ndryshimet që i janë bërë ligjit nr.j 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” tatimpaguesit me xhiro deri në 5 milion lekë përjashtohen nga pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Gjithashtu ulet me 2.5% tatimi për subjektet me xhiro 5 deri në 8 milionë lekë/vit si dhe hiqet pragu minimal i pagesës së tatimit nga tatimpaguesit prej 25 mijë lekë/vit. Si rrjedhojë, efektet financiare për buxhetin e bashkisë Berat nga heqja e këtij tatimi janë tejet të rënda, pasi ky tatim është ndër zërat kryesore të buxhetit të bashkisë sonë.

Sic e kemi theksuar, nevojitet që agjenti tatimor të ushtrojë kontrole të imtësishme të pasqyrave financiare të paraqitura nga këto kategori biznesesh, gjë e cila duhet të reflektohet në rritje të të ardhurave që duhet ti kalojnë Bashkisë Berat.

Grafikisht paraqesim të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël si dhe nga taksa vendore mbi biznesi i vogël (në kohën kjo taksë ekzistonte).

Grafiku nr. 5

Ecuria në vite e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe taksa vendore mbi biznesin e vogël





BASHKIA BERAT

a. Të ardhurat nga taksat vendore

Kryesisht këto të ardhura mbledhen nga Bashkia Berat si dhe nga agjentët tatimorë.

- Të ardhurat nga taksat vendore për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 88,895,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 117,127,000 lekë ose 76 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 73,836,000 lekë të ardhurat e vitit priten të realizohen me +15,059,000 lekë ose +20 % më shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike si dhe taksa e mjeteve të përdorura.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin taksa e tabelës për qëllime identifikimi, taksa mbi ndërtesën që arkëtohet nga biznesi, e cila në pesë vitet e fundit shënon rritje nga njëri vit në tjetrin, taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë, taksa e mjeteve të përdorura, taksa e fjetjes në hotel dhe përgjithësisht të ardhurat nga zënia e hapësirave publike.

Për zërat e të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore dhe nga taksat mbi ndërtesat (si për familjet ashtu edhe për biznesin), arkëtimi i vitit 2015 është në nivelin më të lartë që është realizuar gjatë periudhës 2005-2014.

Efektin dominues në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat vendore e ka mosrealizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë (leje ndërtimi) dhe nga taksa mbi tokën bujqësore. Është pikërisht mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara nga lejet e ndërtimit, i cili sikurse e theksuam më sipër, si rrjedhojë e ndryshimeve që i janë bërë ligjit të urbanistikës dhe bllokimit të dhënies së lejeve të ndërtimit ndikon ndjeshëm në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.

Pasqyra nr. 5

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore

në /000 lekë


Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Taksat vendore	49,725	48,529	55,396	85,395	73,565	74,966	65,146	63,867	70,361	88,895

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga taksat vendore. Viti aktual 2015 shënon pikën maksimale të arkëtimeve nga taksat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 6

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore





BASHKIA BERAT

b. Të ardhurat nga tarifat vendore

Kryesisht këto tarifa mbliidhen nga Drejtoria e Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime Berat – Kucovë.

- Të ardhurat nga tarifat vendore për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 82,156,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 75,241,000 lekë ose 109 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 70,361,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 janë realizuar me +11,795,000 lekë ose +17 % më shume se realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndricimit, gjelbërimit që mbliidhen nga biznesi dhe nga familjet

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel shumë të mirë realizimi.

Përvec realizimit në nivel shumë të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Nivel shumë të mirë realizimi shënoi edhe tarifa e regjistrimit për subjektet e rinj të biznesit që tregon punë të mirë të kryer në drejtim të uljes së informalitetit, por që duhen shfrytëzuar të gjitha potencialet në drejtim të regjistrimit të subjekteve që u shmangen detyrimeve tatimorë.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifat e institucioneve shtetërore.

Theksojmë se Bashkia Berat i ka kushtuar vëmendje maksimale arkëtimit të të ardhurave nga tarifat e familjes. Nëpërmjet futjes së këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm është zgjeruar baza e tatimpaguesve dhe ka sjellë rezultate poitive në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu ndaj cdo qytetari, i cili kërkon që ti ofrohet një shërbim i caktuar administrativ nga bashkia, kërkohet që ai të paraqesë librezën e taksave ku të ketë likujduar taksat dhe tarifat vendore.

Në drejtim të rritjes së të të ardhurave nga familjet kemi kërkuar edhe mbështetjen e gjithë drejtorive rajonale për pagesën e detyrimeve të punonjësve të tyre, por që nuk kemi gjetur mbështetje në të gjitha këto struktura.

Pasqyra nr. 6


Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore

në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Tarifat vendore	29,331	31,387	35,334	52,489	36,369	35,599	35,816	40,857	70,361	82,156

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se pothuajse gjatë gjithë periudhës vazhdon trendi rritës i të ardhurave nga tarifat vendore. Viti 2015 shënon pikën maksimale të arkëtimit nga tarifat vendore.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore shihet në grafikun e mëposhtëm.

**Grafiku nr. 7****Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore****c. Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit**

Këto tarifa mbliidhen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit

- Të ardhurat nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 10,249,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 11,200,000 lekë ose 92 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 10,204,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 priten të realizohen me +45,000 lekë ose përafërsisht në të njëjtën përqindje sa realizimi i vitit të kaluar.

Pasqyra nr. 7**Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit**


në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhura nga D.E.A	13,853	15,900	8,704	8,864	10,568	10,908	9,657	9,239	10,204	10,249

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se në 5 vitet e fundit nuk kemi luhatje të mëdha të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë.

Viti 2007 shënon pikën maksimale të arkëtimit nga të ardhurat e Drejtorisë Ekonomike të Arsimit.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave nga kjo Drejtori shihet në grafikun e mëposhtëm

Grafiku nr. 8**Ecuria në vite e të ardhurave nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit**



BASHKIA BERAT

d. Te ardhurat e tjera

Këto të ardhura mbledhen nga Drejtoritë e Bashkisë si dhe nga ndërmarjet e varësisë.

- Të ardhurat e tjera për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 11,015,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 18,667,000 lekë ose 59 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 12,541,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 priten të realizohen me -1,526,000 lekë ose -12% më pak së realizimi i vitit të kaluar.

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë të ardhurat nga të ardhurat nga qëratë nga ndërtesat dhe pajisjet, të ardhurat nga parkimi, të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat e tjera.

Nivel shumë të mirë realizimi paraqesin të ardhurat nga gjobat dhe të ardhurat nga parkimi.

Efekt vendimtar në mos realizimin e të ardhurave nga ky zë e kanë kryesisht mos realizimi i të ardhurave nga qëratë dhe të ardhurat e tjera.

Pasqyra nr. 8

Ecuria në vite e të ardhurave të tjera


në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Të ardhura të tjera	3,617	5,793	2,746	3,254	7,611	8,882	9,973	29,244	12,541	11,015

Karakteristikë e të dhënave të pasqyrës së mësipërme është fakti se kemi luhatje të arkëtimit të të ardhurave nga ky zë. Luhatjet në këtë zë janë më të mëdha për faktin se shpesh herë gjatë viteve nënzhërat e këtij grupi janë konfiguruar si pjesë e grupeve të tjera të të ardhurave. Megjithatë është për tu theksuar fakti se nga viti 2008 dhe në vazhdim vazhdon trendi rritës i të ardhurave të tjera. Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 9

Ecuria në vite e të ardhurave të tjera



**e. Të ardhurat nga legalizimet**

Këto të ardhura mbledhen nga agjenti A.L.U.I.Z.N.I

- Të ardhurat nga legalizimet për vitin 2015 priten të realizohen në shumën 985,000 lekë kundrejt planit vjetor prej 6,506,000 lekë ose 15 %.
- Kundrejt realizimit faktik të vitit 2014 prej 10,000 lekë të ardhurat e vitit 2015 priten të realizohen me +975,000 leke më shumë se realizimi i vitit të kaluar.


Pasqyra nr. 9**Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet**

në /000 lekë

Vitet	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Te ardhurat nga legalizimet	-	-	2,221	22,073	4,024	3,998	1,555	1,569	10	985

Viti 2014 shënon pikën minimale të arkëtimeve nga të ardhurat nga legalizimet. Karakteristikë është fakti se pas vitit 2009, vit pas vitit të ardhurat nga ky zë po shënojnë rënie.

Më qartë ecuria në vite e të ardhurave të tjera shihet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 10**Ecuria në vite e të ardhurave nga legalizimet****ANALIZA E REALIZIMIT TE SHPENZIMEVE KORRENTE**

Shpenzimet ne total ne vitin 2015 jane realizuar ne masen 81 % ose ne vlere absolute ne shumen **441 912 000 leke, kundrejt 546 738 000 leke te planifikuara**, ne raport me vitin 2014 ku realizimi ishte 89 %, dhe ne vlere absolute ne shumen 411 848 0000 leke. **Shpenzimet korrente** (Paga, sigurime dhe shpenzime operative dhe te mirembajtjes) jane realizuar ne masen 89 %, kundrejt 91.2 % realizuar ne vitin 2014.

Pare ne menyre analitike, realizimi i planit te shpenzimeve eshte ne funksion te plotesimit te funksioneve te veta, te perbashketa dhe te deleguara te percaktuar qarte ne Ligjin nr.8652 date 30.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 10

Pasqyra permbledhese e realizimit te shpenzimeve korrente sipas ndarjes ekonomike

në 000/lekë

Llogaria ekonomike	Plani 2015	Fakti 2015	% e realizimit
600 (paga)	166,612	155,414	93
601 (Sigurime shoqerore)	27,688	24,559	89
602 (shpenz.operative)	229,082	195,961	86
Totali	423,382	375,934	89

Analiza sipas grupeve te shpenzimeve rezulton si me poshte :

1. **Zeri shpenzime personeli. Pagat e personelit** u realizua ne Shumen 131 112000 leke kundrejt 144 374 000 leke te planifikuara, realizimi ne 91%.

Pasqyra nr. 11

Pasqyra e realizimit te zerit paga ne vite


në

000/lekë

Funksioni	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Administrata e Bashkise	55,458	60,912	63,326	56,255	56,838	59,117	79,954
Arsimi	18,260	23,064	20,421	23,623	24,884	23,566	23,098
Qendra Kulturore	17,419	18,471	17,505	14,336	13,540	11 063	11,996
Gjelberimi	16,781	16,640	16,781	16,282	16,666	16,351	18,782
Rruge Trotuaret	11,656	12,912	12,390	11,830	12,233	12,320	12,655
Qendra Lira	-	8,559	9,501	8,753	9,225	8,695	8,718
Totali	119,574	140,558	139,924	131,079	133,386	131,112	155,202

Grafiku nr. 11

Dinamika e shpenzimeve per paga





BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 12


Realizimi i zerit sigurime shoqerore dhe shendetesore ne vite

në 000/lekë

Funksioni	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Administrata e Bashkise	10,235	9,823	10,270	9,186	9,443	9,856	11,954
Arsimi	3,344	3,585	3,293	3,810	4,126	3,906	3,810
Qendra Kulturore	3,112	2,988	2,845	2,343	2,248	1,848	2,002
Gjelberimi	2,920	2,451	2,707	2,648	2,783	2,731	3,164
Rruge Trotuaret	2,021	1,970	2,098	1,887	2,024	2,050	2,164
Qendra Lira	-	1,386	1,493	1,484	1,541	1,352	1,465
Totali	21,632	22,203	22,706	21,358	22,165	21,743	24,559

Grafiku nr. 12

Dinamik e shpenzimeve per sigurime shoqerore dhe shendetesore ne vite



Viti 2012 shenon ulje te fondit te pagave ne vlerë absolute Shumen pre 8845 000 leke, sigurime shoqerore 1348 000 leke, ulja ne indeks eshte 7 % ne krahasim me vitin 2011, kjo per faktin se ne vitin 2012 kemi reduktim te nr. te punonjesvee (52 punonjes te shkurtuar ne administraten e bashkise dhe sektoret mbeshtetes te saj,per shkak te gjithe problematikes financiare te trajtuar.)

Ne vitin 2014 ashtu sikurse ne vitet 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, **fondi i vecante** sipas kufizimit ligjor te vendosur nga Qeveria nuk eshte perdorur per te shperbyer punonjesit per rezultate ne pune, ndihma te menjehereshme ne rast fatkeqesie, shperblim per dalje ne pension te punonjesve, veprimtari social kulturore etj.

Zerit sigurime shoqerore dhe shendetesore u realizua ne masen 89% ne vlerë absolute **24,559,000** leke, duke derdhur rregullisht kontributete e sigurimeve shoqerore e shendetesore.

2. Zeri shpenzime operative u realizua ne masen 86% .



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 13


Realizimi i zerit shpenzime operative ne vite

në 000/lekë

Funksioni	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Administrata e Bashkise	13,797	11,705	10,617	12,033	11,432	15,188	17,815
Arsimi	20,536	22,892	17,485	20,194	23,062	28,330	28,000
Kultura dhe sporti	23,494	21,967	20,511	38,446	21,314	29,400	9,727
Futbolli	9,758	8,728	11,477	25,950	12,975	16,500	29,700
Pastrimi, dekori, varrezat, ujesjellesi	51,000	46,802	37,718	44,540	51,170	67,620	56,293
Transporti urban	8,941	3,759	2,287	4,879	4,879	6,000	1,200
Gjelberimi	5,753	4,432	3,358	5,046	4,391	4,487	10,200
Rruge Trotuaret	20,762	24,142	17,554	26,408	18,989	21,305	28,800
Kontr. i Keshillit te Qarkut	4,000	4,000	2,331	1,750	3,000	4,000	5,500
Fond Rezarve +Emergjencat	4,195	2,835	930	1,807	666	1,000	500
Familjet ne nevojë	389	577	584	507	900	900	998
Det Kontr. UKBK +(transfera BID)	-	1,500	1,230	-	-	368	2,015
Qendra Lira	1,072	3,172	2,685	3,381	3,869	4,640	4,800
Totali	162,739	156,718	126,598	168,029	153,812	193,363	195,961

Grafiku nr. 13

Dinamika e shpenzimeve operative ne vite





BASHKIA BERAT

Ng ate dhenat e mesiperme konstatohet lehtësisht fakti se grupi i shpenzimeve operative ka pesuar luhatje dhe nuk kan trend rrites nga njeri vit ne tjetrin.

Ne vitin 2011 kemi 30 120 000 leke me pak shpenzime operative se ne vitin 2010, por duhet te theksojme faktin se viti 2011 u mbyll me deficin buxhetor prej 51 239 000 leke nga te cilat 43 768 000 leke e perbenin shpenzimet operative te kryera e te palikujduara. **Deficiti buxhetor krijon paaftesi paguese.**

Viti 2012 ka nje nivel te realizimit te shpenzimeve prej 168 029 000 leke ose 41 431 000 leke me shume se fakti i vitit 2011, qe do te thote **se mbartja e deficitetit rriti artificialisht nivelin e shpenzimeve.**

Ne vitin 2013, ndodh po e njehta situatë, **mbartja e borxhit te trasheguar nga viti 2012 ne shumen 49 557 300 leke, rriti planin e shpenzimeve te vitit buxhetor 2013.**

Ne vitin 2014 shpenzimet operative ne total prej **193,363 000 leke, kane** nje rritje prej **27%** ne krahasim me vitin 2013, rritje artificial per shkak te likuidimit te borxheve te mbartura.

Ne vitin 2015 shpenzimet operative ne total jane ne vleren 195,961,000 leke pra eshte pothuajse ne te njejtin nivel me vitin 2014 qe do te thote se eshte bere nje menaxhim i mire i financave ne drejtim te shpenzimeve operative me gjithë bashkimin e njesive administrative te shkrira

Sipas ndarjes ekonomike analiza eidenton :

- **Perdorim eficient te fondeve** ne dispozicion ne perputhje me strukturen buxhetore te miratuar.
- **Zbatim korrekt te akteve ligjore e nenligjore** qe rregullojne perdorimin e tyre.
- **Pergjegjshmeri administrative dhe financiare** deri tek administrator me i drejteperdrejte per cdo shpenzim te kryer.
- **Ekonomizim, limitim te perdorimit te fondeve nga njesite shpenzuese** duke mos cenuar nivelin dhe cilesine e kryerjes se sherbimit.
- **Auditim dhe kontroll** te Njesite Shpenzuese dhe drejtorive per zbatimin e ligjishmerise nga njesia e auditit te brendshem dhe KLSH.

ANALIZA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE:

I. Programi i administrates se bashkise (planifikim, menaxhim, administrim)

Pershkrimi i Programit. Realizon menaxhimin financiar te Bashkise Berat dhe perfshin shpenzimet e nevojshme administrative per mbarvajtjen e punes ne permbushjen e funksioneve te percaktuara ne legjislacion.

Politika e Programit. Politika e ketij programi konsiston në përmirësimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë Berat, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit



BASHKIA BERAT

te vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 8 pika 1/c, neni 32 pika ç, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. datë "Mbi miratimin e strukturës organike, të numrit të punonjësve pagat e administratës, ndërmarrjeve dhe njësive shpenzuese në varesi të Bashkisë Berat për vitin 2014" u miratua struktura e Bashkisë Berat dhe e njësive Shpenzuese në varesi të saj.

Programi i administratës së bashkisë, është realizuar me 184 punonjës (pas shtesave që u bënë me bashkimin e ish komunave), të miratuar **me objektiv:** zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese, garantimin e përmirësimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të bashkisë, të ofrojë një partneritet, kordinim dhe mirëkuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale të punës në shërbim të komunitetit.

Pasqyra nr. 14

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi ne %
Paga	83,825	80,166	96
Sigurime shoqërore	14,003	11,954	85
Shpenzime operative	25,839	17,815	69
Totali i shpenzimeve korrente	123,667	109,935	89
Investime	17,194	745	4
Totali i shpenzimeve	140,861	110,680	79

Zeri; paga është realizuar në masën 96 % ose mosrealizimi në vlerë absolute prej 3,659,000 leke, për arsye se : Vendet të punës vakant për shkak të procedurave të rekrutimit të punonjësve në bazë të ligjit "Për statusin e nënpunësve civil", krijuan kursim të fondit të pages. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 591 datë 10.07.2013 **"Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2013"** pezulloi përdorimin e fondit të vecantë për shpërbimin e punonjësve për rezultate në punë

Zeri; sigurime shoqërore është realizuar në masën 69%, janë derdhur rregullisht kontributet.

Zeri ; shpenzime operative është realizuar në masën 89% kundrejt detyrës së planifikuar, dhe 100% kundrejt planit të celtur, mosrealizimi në masën 13 732 000 leke.

Produktet që u realizuan

- Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë.
- Sigurimi i materialeve dhe shërbimeve speciale.



BASHKIA BERAT

- Realizimi i shërbimeve ndaj të tremeve.
- Realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Sigurimi i levizjes së nënpunësve dhe realizimi i shpenzimeve të transportit.
- Mirembajtja e mjeteve të transportit, pajisjeve të zyrave dhe vet ambjentëve të zyrave nëpërmjet realizimit të shpenzimeve të, mirembajtjes së zakonshme.
- Realizimi i shpenzimeve për pritje përcjellje.
- Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Ne zërin e shpenzimeve veprimtari dhe aktivitete Te vitit 2015, Janë likuajduar edhe aktivitetet dhe veprimtaritë e zhvilluara në vitin 2014, e të mbartura si detyrime në vitin 2015.

Te tilla si: Shpenzime të aktivitete të festive të, Ceremonia “Njeriu i Vitit 2014” dhe festat e fundvitit. Viti buxhetor 2015 nuk rezulton me detyrime të palikujduara, me përjashtim të aktiviteteve që realizohen në ditët e fundit të dhjetorit.

II . PROGRAMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITARE DHE EDUKIMIT

Përshkrimi i programit. Programi i arsimit parauniversitar dhe edukimit parashikon veprimtarinë ekonomike,financiare dhe atë të shërbimit në mirembajtjen e kopshteve,cerdheve dhe shkollave 9-te vjeçare,të mesme të përgjithshme dhe profesionale që janë brenda teritorrit dhe juridiksionit të Bashkisë Berat tashmë të zgjeruar.

Objektivat e programit: Përbushjen me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit , synimi i përbushjes së standarteve të miratuara nga M.A.SH në Strategjinë e Arsimit, përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit në cilësinë e shërbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe në forcimin e kontrollit të fondeve të planifikuara në buxhetin e arsimit, mirembajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave të qytetit, duke synuar në përbushjen e standarteve optimale.

Njësia Shpenzuese; Qendra Ekonomike e Arsimit

Fondi i planifikuar në këtë program: **61,646,000 leke**, fondi i realizuar: **55,117,000leke**,

Pasqyra nr. 15

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi në %
Paga	23,892	23,097	97
Sigurime shoqërore	3,912	3,810	97
Shpen. operative	32,132	28,000	87
Totali i shpenzimeve korrente	59,936	54,907	92
Investime	1,710	210	12
Totali i shpenzimeve	61,646	55,117	89



BASHKIA BERAT

Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen **89%** , mosrealizimi ne shumen prej 6,529,000

Zeri **paga** dhe **sigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen **97%**, **jane** paguar ne kohe pagat e punonjesve e jane duke derdhur rregullisht sigurimet shoqerore dhe shendetesore.

- Realizimi ne masen 92% **te shpenzimeve operative**, kundrejt 93% realizimi ne vitin 2014, realizim ne nivele relativisht te kenaqeshme, tregon **vemendjen maksimale** ndaj ketij **funkcioni te perbashket** midis Qeverisjes Vendore dhe asaj Qendrore, ndersa kundrejt planit te shpenzimeve te celura rezulton realizimi ne masen **100%**, **gje qe tregon se institucioni ka mireadministruar fondet.**

➤ **Produktet u realizuan:**

1. Materiale zyre e te pergjithshme. Ketu perfshihen te gjitha materialet per pastrim, disifektim, ngrohje e gatim per nevojat e kopshteve, cerdheve, shkollave, konviktit dhe administrates se qendres ekonomike.
2. Materiale dhe sherbime te tjera special: si uniforma dhe veshje speciale, ushqimet e femijeve, ilace mjeksore si dhe te tjera materiale dhe sherbime speciale per nevojat e kopshteve, cerdheve, konvikteve dhe shkollave te qytetit.
3. Sherbime nga te trete .Perfshihen te gjitha shpenzimet per energjine elektrike, ujin e pijshem dhe telefon per te gjitha institucionet e arsimit parashkollor, 9-te vjecar, te mesem te pergjithshem e profesional si dhe te cerdheve.
4. Shpenzime transporti, shpenzimet per transportin e ushqimeve te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve te qytetit.
5. Mirembajtje te zakonshme, materialet per mirembajtje te ndryshme, riparime e lyerjen e objekteve arsimore.
6. Shpenzime te tjera operative

Analiza ekonomike e treguesve analitik te shpenzimeve operative evidenton faktin se :

- **40%** te tolalit te shpenzimeve operative ketij institucioni kalon per llogari te pagimit te ushqimit te kopshteve, cerdheve dhe konvikteve,
- **50 %** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te sherbimeve ndaj te treteve, energjise elektrike, ujit, telefonit.
- **3%** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per qera mabjenti.
- **3%** te tolalit te shpenzimeve operative te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per shpenzime administrative.
- **4%** (te tolalit te shpenzimeve operative leke te ketij institucioni kalon per llogari te shpenzimeve per mirembajtje.

Qendren Ekonomike e Arsimit mbylli vitin buxhetor 2015 pa detyrime te palikujduara.

**4. PROGRAMI I SHERBIMEVE PUBLIKE****1. Mirembajtje rruge trotuare dhe ndricim publik**

Njësia Shpenzuese: Ndërmarrja e Rugë Trotuareve dhe Ndicimi Publik.

Fondi i planifikuar 48,075,000 leke, fondi i realizuar 44,319,000

Pasqyra nr. 16

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi ne %
Paga	13,670	12,655	93
Sigurime shoqerore	2,238	2,164	97
Shpen. operative	31,467	28,800	92
Investime	700	700	100
Totali i shpenzimeve	48,075	44,319	92

Pershkrimi i Programit. Programi i Mirëmbajtjes së rruge trotuareve dhe ndicimit publik me 35 punonjes, parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldremeve, mirembajtjen e sistemit të ndicimit të qytetit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.

Objektivat e Programit. Te realizojme mirembajtjen e rrugeve në masën 80-85% të mirembajtura mire dhe shumë mire, përmirësimin e rrjetit ekzistues të rrugëve të asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve,

Produktet që u realizuan:

1. Mirëmbajtja e Rugëve dhe Trotuareve

Jane mirembajtur : Siperfaqe me rruge të asfaltuara 205000 m², siperfaqe që trajtohen me stabilizant janë 75860 m², siperfaqe të shtruara me kalldrem janë 61000 m², siperfaqe me trotuare janë 65000 m², mure mbajtës 500 m², kapak pusëtash 580 cope, ujembledhës 490 cope, si dhe zgara pritese 35 cope. Ky element shpenzimi ze 11 % e buxhetit të shpenzimeve operative të Ndermarrjes.

2. Mirëmbajtje Ndrichimi Rrugor. Mirëmbajtja e rrjetit të ndricimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të ndricimit rrugor në rrugët e qytetit, riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, që kap një siperfaqe të ndicuar prej 1 503 000 m². Rrjeti i ndicimit publik mbulon relativisht qytetin dhe komandohet neprnjet 50 gabinave, inventari i shtyllave elektrike me gjatësi 8 ml është 1050 cope. Ndicimi publik, si element shpenzimi ze 80% të buxhetit të shpenzimeve operative të Ndermarrjes.

3. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore



BASHKIA BERAT

Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarrës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.

4. Dekori

Ne vitin 2015 Ndermarrjes se Rruge Trotuarve I eshte shtuar dhe dekori I qytetit I cili me pare ishte sherbim I kontraktuar me operator ekonomik privat. Gjate vitit ndermarrja ka bere dekorimin e qytetit me rastin e fesatve.

Gjelberimi dhe mirembajtja e varrezave

Pershkrimi i Programit. Programi “Gjelberimi,” me 56 punonjes konsiston ne mirëmbajtjen e siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekurative, bordure te gjelber, mbjellja e pemeve dekurative etj. Shtim te siperfaqeve te gjelberta, duke synuar mobilimin e gjelber te cdo rruge, sheshi dhe shtimin e parqeve per femijet, si nje dekor edukues e atraktiv per qytetin dhe qytetaret.

Njësia Shpenzuese: Ndermarja e Gjelberimit

Fondi i planifikuar 35,961,000 leke, fondi i realizuar 32,266,000 leke.

Pasqyra nr. 17

Realizimi i shpenzimeve

në 000/lekë

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi ne %
Paga	20,892	18,782	90
Sigurime shoqerore	3,551	3,164	89
Shpen. operative	11,398	10,200	89
Totali i shpenzimeve korrente	35,841	32,146	90
Investime	120	120	100
Totali i shpenzimeve	35,961	32,266	90

Sic shihet dhe nga tabela Ndermarrja e Gjelberimit dhe Sherbimit te Varrimit ka nje rritje ne fondet e planifikuara krahasuar me vitin 2014 me 41% ose ne vlerë absolute 10,477,000 leke dhe **kjo vjen si pasoje e shtimit te sherbimit te varrimit** I cili eshte shoqeruar me shtim personeli qe perkthehet ne fond page dhe sigurimi me te madh se ai I vitit te meparshem si dhe shpenzime operative me te larta per perballimin e ketij sherbimi I cili me pare eshte bere me kontraktim me operator ekonomik privat.



BASHKIA BERAT

Objektivat e Programit; Mirembajtjen e strukturese siperfaqeve te gjelberta duke kryer te gjitha proceset teknologjike te punes per mirembajtjen e siperfaqeve me bar, lulishte, shkurre dekorative, bordure te gjelber.

- ❖ Shtimi i siperfaqeve te gjelberta duke shtuar mbjelljet me lule zezonale, sip, me bar, mbjellja e pemeve dekorative etj.
- ❖ Reabilitimin e sistemit te rrugicave dhe shesheve te pushimit ne lulishten e qendres.
- ❖ Reabilitimi i sistemit te ujitjes ne lulishten e qendres.
- ❖ Reabilitimi i sistemit te ujitjes ne lulishten e rruges hyrese te Beratit.
- ❖ Ndertimi i Tendave dhe i pjergullave.
- ❖ Kompletimi me stola dhe tavolina per te krijuar vende shplodhje per qytetarët.
- ❖ Sistemim i gjelbert i bankinave te lumit “Osum”.
- ❖ Ofrimi I nje sherbimi sa me cilesor per sa I perket sherbimit te varrimit I cili kerkon nje angazhim 24 ore ne dite dhe 7 dite ne jave.
- ❖ Mirembajtje e varrezave publike dhe atyre te Deshmoreve te Kombit.

Produktet që u realizuan;

1. Mirëmbajtje e strukturese gjelbert ne qytetin e Beratit:

- Kryerjen e të gjitha proceset teknologjike të punës si në një sipërfaqe prej 79 274 m².siperqafe rruge dhe sheshe 15 331 m², sip. me bar dekorativ 57 486 m², sip. me lule sezonale 3 748 m², drure zbukuruese rrugore 5 600 rrenje, gardh i gjelbert 1 120 ml, tunel i gjelbert 50 ml.
- Mirembajtjen e 14 tendave te gjelberta dhe 10 qoshka dekorative, kangjella dekorative 2 112 ml,
- Mirëmbajtje e gjithë inventarit te pershire ne siperfqet e gjelberta si, stola, pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndicuesa, cezma zbukuruese, kende lojrash per femije, e kende arhetuese per moshat e treta, lapidar, buste, skulptura.

2. Mirembajtje e varrezave publike dhe varrezat e deshmoreve

Gjate vitit ndermarrjes se gjelberimit iu shtua dhe sherbimi I varrimit dhe i mirembajtjes se varrezave publike sherbim te cilin ndermarrja e ka realizuar me sukses, duke i vene fonde ne dispozicion.

Pastrimi i qytetit

Përshkrimi i Programit. Programi i shërbimit të Pastrimit parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet.

Njësia Shpenzuese; Sipërmarrja e pastrimit.

Fondi i planifikuar 54,496,699 leke, fondi i realizuar 53,396,970leke.



Objektivat e Programit;

- Pastrimin e Rrugëve dhe Shesheve kryesore të qytetit për tu krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike).
- Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, institucione publike) si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore në standarde që kërkon koha.
- Larja dhe lagia e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
- Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimin e mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
- Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevralgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj..)

Produktet që u realizuan;

1. Pastrimi i Rrugëve

- Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.

2. Mirëmbajtja e Ambienteve Publike

- Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen blloqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.

3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane

- Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.
- Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.

5. Lagje e rrugëve

- Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagje të rrugëve kryesore gjatë sezonit Maj-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

6. Dizinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektimi



BASHKIA BERAT

- Dizinfektimin, deratizimin, dizinsketimin e ambienteve publike për të pasur një ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

7. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit

- Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

3. Transporti Urban.

Njësia Shpenzuese; Bashkia Berat (subvencioni)

Ndermarrja: Parku i Udhëtareve Berat.

Gjate viti 2015 shërbimi i transportit urban është kryer nga Ndermarrja me status Ndermarje Shtetërore deri në momentin e shkërretjes së saj **dhe kalimit të shërbimit të transportit urban me operatori ekonomik privat**. U planifikua në fillim të vitit për shërbimin e transportit urban një fond prej 6 000 000 leke prej të cilave iu alokuan ndërmarrjes 1 200 000 leke dhe fondi i mbetur prej 4 800 000 leke u riallokua për nevojat e bashkisë me Vendim të Këshillit Bashkiak. Astetë e mbetura të drejtat dhe detyrimet e **Ndermarrja: Parku i Udhëtareve Berat iu kaluan Ndermarrjes rrugë Trotuare dhe ndicim Publik**.

PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË KULTURËS, TURIZMIT DHE SPORTIT

Përshkrimi i programit. Programi i kultures tenton të japë një hapësirë edhe me të plotë jetës artistike dhe kulturore të qytetit jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e metejshëm të projekteve ekzistuese, të cilat janë kthyer tashmë në një traditë për qytetin e Beratit, por edhe duke dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovative të cilat vijnë pranë Qendres Kulturore e Bashkisë Berat nga persona të trete, shoqëria civile apo entë të tjera kombëtare e ndërkombëtare. Ky program do të tentojë të promovojë vlerat kulturore të qytetit që ka do të bente jo vetëm për qytetarin e Beratit, por edhe turistin dhe vizituesin e tij, me atraktiv.

Njësitë shpenzuese: Bashkia Berat



Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”

Fondi i planifikuar në këtë program 28,256,000 leke, fondi i realizuar 24,998,000 leke

Ka funksionuar edhe për vitin 2015 si një njësi shpenzuese duke pasur në përberje funksionimin e Qendres Kulturore “Margarita Tutulani”, Bibliotekës “Vehxhi Buharaja”, Galerisë së Arteve “E. Lear” si dhe Klubin e shumesporteve “Tomorri”, me një personel prej 24 punonjësish.



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 18

Realizimi i shpenzimeve per Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi ne %
Paga	14,221	11,996	84
Sigurime shoqerore	2,328	2,002	86
Shpenzime operative	9,727	9,727	100
Investime	1,980	1,273	64
Totali i shpenzimeve	28,256	24,998	88

Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 88%, moserealizimi ne vlere absolute ne masen 3,258,000 leke. Zeri **paga** dhe **sigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen 84 e 86 %, duke mos krijuar deficit. Realizimi ne masen 100%,**te shpenzimeve operative**, kundrejt 77% te realizuar ne vitin..2014.

Qendra kulturore “M.Tutulani” luan një rol të rëndësishem ne zhvillimin e jetes kulturore,sportive si dhe promovimin ne aktivitete kombetare dhe nderkombetare te vlerave artistike, kulturore e sportive qe ka qyteti i Beratit.Funksionon si njesi shpenzuse e Bashkise Berat dhe ne varesine e saj jane biblioteka “Vehxhi Buharja”, galeria “E.Lear”, klubi shume sportesh “Tomori.

Qendra Kulturore me gjithë aktivitete e saj si Qender, te Bibliotekes “V.Buharaja” Galerise se Arteve “Edwart Lear” , te Klubi i shumesporteve “Tomorri”, mbylli vitin buxhetor 2015 pa detyrime.

Aktivitetet e zhvilluara per vitin 2015 jepen ne tabelat e meposhteme:

Pasqyra nr. 19

Aktivite te zhvilluara ne Qendren Kulturore “Margarita Tutulani”

Nr.	Data	aktiviteti
1	14- Shkurt	San valentini dita e te dashuruarve
2	19-Shkurt	Teater komedia “Propozimi”
3	21-Shkurt	Montazh letraro artistik ne miniskene e katit te 2-te
4	22-shkurt	Performanc e gkkq per konkurrimin ne TRT music Turkia
5	2-Mars	ansambli knges dhe valles per ffgjirokaster 2015
6	5-Mars	Bashkpunim me medresen
7	6-mars	dita e mesuesit
8	8-mars	dita e nenes
9	14-Mars	ardhja e pranveres “Dita e veres”
10	27-Mars	Dita nderkombetare e Teatrit



BASHKIA BERAT

11	7-Prill	festival folk per femije audicionet
12	8-Prill	Koncert Prezantimii pare i ekipite artisteve qe do perfaqesojen q.b.ne fflkgj2015
13	22/23 -Prill	Prill Kinema ne bshkepunim me imperila
14	5-Maj	Dita e Deshmoreve ekspozite dhe koncerte me orkestren simfonike
15	6-Maj	aktivitet sensibilizus dita nderkombetare e romeve
16	9-Maj	Happy Europe Day europëe day dhe 70-vjetori dita nderkombetare mbi nazifashizmin
17	16-17-18 Maj	F.F.K.Gjirokaster 2015 “Argjiro Fest_ON”
18	29-30 Maj	festivali 44 per femije
19	Qershor	Teatri kukullave ne Pogradec
20	8- Korrik	Berati në UNESCO Grupi kenges qytetare concert ne 7-vjetorin e Beratit ne UNESCO
21	23-Korrik	festivali multi kulturor23-Korrik performance grupi kenges qytetare
22	29-30-31 Korrik dhe 1 Gusht	Kinema verore me filma per femije te dubluar shqip per femijet e qytetit (në pedonale)
23	2 - Gusht	koncert kushtuar 15-vjetorit te renies se Arben Zylyftarit
24	3 -Shtator	Promovimi i librit kushtuar heroit të Popullit Zylyftar Veleshnja
25	13 - Shtator	montazh letrar artistik clirimi i beratit
26	23 – Shtator	Teatri kukullave morri pjese ne festivalin boteror “Dodona” ne Prishtin dy cmime
27	25- Shtator	Komedia “Enderra e nje nate burgu
28	29- shtator	Dita Kombetare e Trashegimisë Kulture
29	16- Tetor	Aktivitet me grupe folklorike te qarkut Berat Play & dance cmim ne dures
30	18- tetor	Play and dance ne qkmt edivcioni 18
31	22 tetor	Aktivitet i perbashket me një grup artistesh arbrësh
32	22-tetor	Fantastik “SHOW” varjete numra shpejtesie
33	29- Tetor	Premier Koncert instrumental – vokal
34	31-Tetor	Aktivitetne kuader te dites Bid
35	31 –Tetor	Bid fest
36	4- Nentor	koncert me rastin e 71-vjetorit te gruas antifashiste
37	5-Nentor	audicionet per shoë rinor
38	13-Nentor	“Drejt Fundit” film aksion shqip 100%
39	20-Nentor	teatri kukullave “Shtepia e Patave”
40	21- Nentor	iso polifoniane vlore
41	27-Nentor	aktivitete per pavarsine ne 102 vjetorin e saj dhe clirimi i atdheut nga okupatori fashist Film Dokumentar er beratit ne pedonale
42	28-Nentor	ekspozite,sketch show
43	29-Nentor	ekspozit lojra,perfomance muzikore live
Parashikohet gjate muajit dhjetor		
44	2- Dhjetor	Orkestra simfonike koncert përkujtimor heroit Hajdar Tafa
45	Dhjetor	“ Show Rinor ”



BASHKIA BERAT

46	25 - Dhjetor	Koncert I Grupi Karakteristik I kenges qytetare sheshi Teodor Muzaka
47	28 - Dhjetor	Orkestra Frymore sheshi T.Muzaka
48	29 - Dhjetor	Teatri Kukullave sheshi Teodor Muzaka
49	29 - Dhjetor	Orkestra Simfonike Salla Q.Kulturore
50	30 - Dhjetor	Koncert Festiv I Fund Vitit Gezuar 2015
51	31 - Dhjetor	Albania Silhouette Dance

Pasqyra nr. 20

Aktivite te zhvilluara ne Galerine Edwart Lear

Nr.	Data	Ekspozitat	Veprat	Autor
1	Janar	Fondi i Galerisë	96	54
2	5 Shkurt	Ekspozita “Trego Historinë e Gjirokastrës”(FOTO)	57	26
3	6 Mars	Ekspozita “Buqetë lulesh 7-8 Marsin” (PIKTURA)	56	27
4	17 Mars	Ekspozita “2 Artistë nga Kosova” (PIKTURA)	35	2
5	21 Prill	Ekspozita “Diktatura dhe demokracia në epokën e ekstremeve”(POSTERA)	26 (postera)	
6	29 Prill	Ekspozita me tre artistë të grupit “Art Color” (PIKTURA)	50	3
7	9 Maj	Ekspozita e piktorit Ruzhdi Keraj (PIKTURA)	30	1
8	1 Qershor	Ekspozita “Kolor’15” (VIZATIME+PIKTURA)	286 vizat.+piktura	150
9	23 korrik	Ekspozita “Origjin” e Alban Nimani (VIZATIME+INSTALACIONE)	29	1
10	10 shtator	Ekspozita e Vlash Drobonikut (VIZATIME ANIMACION)	570 (vizatime)	1
11	9 Tetor	Ekspozita e Gëzim Lallës “Forma i mjafton mendimit”	56	1
12	Dhjetor	Cmimi vitit “Lear 2015”		
Gjithsej: 11 ekspozita të reja			254+26 postera	59

Biblioteka “V.Buharaja”

Ka funksionuar per vitin 2015 si strukture brenda Qendres Kulturore “Margarita Tutulani”, me mision mirembajtjen e fondit te bibliotekes dhe shtimin e numrit te lexuesve per te gjithë grupmoshat, duke synuar shtimin e fondit te materialeve te bibliotekes, zhvillimin e aktiviteteve promovuese e nxites ne funksion te shtimit te lexuesve e kryesisht atyre te rinj ne funksion te promovimit kultures dhe edukimit.

Pasqyra nr. 21

Aktivite te zhvilluara ne Biblioteken “Vexhi Buharaja”

Nr.	Data	aktiviteti
1	21 mars	Dita Nderkombetare e Poezise kushtuar poezise moderne ruse



BASHKIA BERAT

2	18-28 mars	Ativitete ne bashkepunim me Shoqaten e Frankofonise se Beratit ne kuadrin e Javes se Frankofonise ne Shqiperi
3	27 mars	Takim me studjuesit e njohur arbereshe prof. Francesk Altamarin dhe prof. Mateo Mandalen
4	23 prill	Dita Nderkombetare e Librit në një takim me shkrimtarin e njohur Zija Cela dhe kritikun Behar Gjoka.
5	27-30 prill	Bashkepunim me Shoqaten e Miqësise Shqiperi-Rusi dhe Organizaten e Veteraneve të LANC, Biblioteka ka organizuar Ditët e Kinemase Ruse me temë Luftën e Dyte Boterore
6	27-30 prill	Prezantim i muzikes arbereshe me kengetaret L.Stabile dhe C.Pellicano
7	12 maj	Promovimi i librit “Berat, Beratinus, Buhara” te prof. Shaban Sinanit me rastin e 95 vjetorit te lindjes se Vexhi Buharase
8	25 korrik	panairit te librit Bashkepunim me stafin e Festivalit Multikulturor dhurimin e 20 librave per femije, dhurate nga shtepite botuese “Konica” dhe “Shkelzen Zalli” lexuesve te dalluar te saj ne stendat e panairit te librit
9	26 shtator	Promovimin e dy shkrimtareve nga Pogradeci Bujar Balliu dhe Istref Haxhillari, ne kuadrin e pragramit te saj per njohjen dhe promovimin e letersise moderne shqiptare si dhe te autoreve te vleresuar te saj.
10	30 tetor	Promovimi i romanit “Betimi i rreme” me subject ngjarje historike te qytetit te Beratit, te autorit te ri te vleresuar nga Gjitrokastra Odise Kote
11	11 nentor	Promovimin e poetes se re nga treva e Beratit e njohur dhe vleresuar ne Itali, Griselda Doka

Klubi i shumespoteve “Tomorri”.

Pershkrimi i programit. Masivizimin dhe konsolidimin e sistemit sportiv në dobi të shëndetit të shoqërisë sonë që nga fëmijët e kopshteve, të rinjtë, studentët dhe të rriturit.

Edhe per vitin 2015 ka funksionuar si strukture brenda Qendres Kulturore “Margarita Tutulani”, **me mision** nxitjen, zhvillimin dhe përhapjen e kulturës sportive në qytet, nëpërmjet organizimit të projekteve sportive dhe pjesëmarrjes ne aktivitete kombetare dhe nderkombetare.

Objektivi: Rritja e cilësisë sportive te të rinjve pjesëmarrës në ekipe të llojeve të ndryshme të sportit, si ping pongut, bilardos, basketbollit, gjimnastikes, mundjes, boksit, karates, peshengritjes, futbollit të ngritura pranë klubit te ShumSPORTIT.

Arritja e sukseseve kombëtare dhe ndërkombëtare të ekipit ping pongut, mundjes, karates, boksit dhe sporteve te tjera, me gjithë financa te kufizuara ky klub ka arritje e suksese kombëtare dhe ndërkombëtare.

Klubi i shumespoteve “Tomorri” realizoi aktivitetet e listuara ne buxhetin e vitit 2015,

1. Kampionati Kombetar përshkollor 12-13 vjeç. Vlorë 23 deri 26 Prill.
2. Kampionati Kombëtar për 15-16 vjeç. Vlorë 6 deri 10 Maj.
3. Kampionati Kombetar për 17-18 vjeç. Shkodër 1 deri 5 Tetor.



BASHKIA BERAT

Ekipi i Peshengritjes

1. Kampionati Kombëtar për të rinj. Elbasan 28 dhe 29 prill.
2. Kampionati Kombëtar për U 13-17 & U 15-20. Durrës 18 Korrik.

Ekipi i Mundje

1. Kupa e Shqipërisë për shkollorë dhe para të rinj. Tiranë 10 Maj.
2. Kampionati Kombëtar për shkollorë dhe për para rinj. Tiranë 26-27 Shtator.
3. Kampionati Kombëtar për të Rritur. Tiranë 27 nëntor

Ekipi i Ping pong-ut

1. Kampionati Kombëtar për para të reja dhe para të rinj (Ekipor + Individual). Shkodër 28 dhe 1 Mars.
2. Kampionati Kombëtar për të reja dhe të rinj (Ekipor + Individual). Durrës 21 dhe 22 Mars.
Kampionati Kombëtar për U21.
3. Kampionati Kombëtar për të rritur Ekipor, femra + meshkuj. Tiranë 19 Prill.
4. Turneu Mbarëkombëtar “BITT Bureli 2015”. Burrel 1 deri 3 Maj.
5. Kampionati i 23-të Ballkanik për Kadet U15 dhe të Rinj U18, meshkuj dhe femra. Prishtinë 3-7 qershor.
6. Kampionati Kombëtar për të rritur Individual, femra + meshkuj. Tiranë 19 dhe 20 Shtator.
7. Kampionati Ballkanik për U-21. Maqedoni 20 deri 28 Tetor.
8. “Kupa Dardania”. Ferizaj Kosovë 14 dhe 15 Nëntor.
9. Kupa e Shqipërisë. Shkodër 28 nëntor.

Gjimnastike

1. Kampionati Kombëtar për para të Rinj të Rinj dhe të Rritur Më datë 29 Maj
2. Kupa e Republikës. Tiranë 3 tetor..

Basketbolli

1. “Kupa Rinia”. Lushnjë 8 nëntor

Karate

1. Kampionati Kombëtar i femijeve. Tiranë 19 prill 2015
2. “Kamza Open”. Kamëz 17 maj 2015
3. Kampionati Ballkanik i femijeve 30-31 Maj. Herceg-Novi Mali i Zi.
4. Seminari & Kampionati Veror. Mali i Robit 16-23 Gusht 2015.
5. Kupa e Shqipërisë. Kamëz 4 tetor 2015
6. Kampionati i 16 Mbarekombëtar për Kadet, Junior dhe Senior. Tiranë 15 nëntor 2015
7. “Elbasani Open” Elbasan dhjetor 2015
8. “Ballkan Open” Kroaci Dhjetor 2015
9. “Ulqini Open 2015”. Ulqin 5 prill 2015

Alpinizem

1. Ngjitja dimërore në Nemërçkë. Nemërçkë 13 deri 16 Mars.
2. Ngjitja në malin e Shpiragut. Shpirag 4 Maj



BASHKIA BERAT

Pjatel

1. Kupa “Mirash Ndue Lulashi”. Pukë 5 Nëntor.
2. Kampionati Kombëtar i cili do të zhvillohet në muajin dhjetor në pjatelin “Tomori”.

Gjysëm maratona e Beratit

“Gjysmë-Maratona e Beratit” u zhvillua në datën 26 Maj.

Tenis per te gjithë

Në datën 16 Maj në Pedonalen e Beratit u promovua sporti i Tenisit.

Shah

1. Simultane e Shahut në Pedonalen e Beratit në datën 6 Maj.
2. Kampionati Kombëtar për të rinj. Tiranë 8 Maj.
3. Turneu Mbarëkombëtar i Shahut në klasat e teta dhe të nënta. Durrës 30 Maj.
4. Kampionati European për të rinj. Kroaci 17 Shtator.
5. Kampionati Botëror.Kalkidhiki Greqi 24 deri 07 Nëntor.

Gjithsej jane zhvilluar 103 aktivitete kulturore e sportive te cilat jane te dokumentuara me foto te ndara sipas tabelave me sipër deri ne muajin Nentor

Qendra Kulturore me gjithë aktivitete e saj si Qender, te Bibliotekes “V.Buharaja” Galerise se Arteve “Edwart Lear” , te Klubi i shumesporteve “Tomorri”, mbylli vitin buxhetor 2015 pa detyrime.

VI. KF TOMORRI 1923 sh.a.

KF TOMORRI 1923 sh.a. është financuar nga bashkia ne masen 100% te nivelit te planifikuar, ne Shumen 29,700,000 leke, (jane bere dhe shtesa ne buxhet gjate vitit 2015), kundrejt 16 500 000 leke, ne vitin 2014, si dhe jane siguruar te ardhura nga biletat ne shumen 56 400 leke si dhe nga merkato 400 000 leke, 30 000 leke qera salle.

Totali i te ardhurave te perdorura eshte 30 186 400 leke. I gjithë fondi eshte konsumuar ne baze te planit financiar te sh.a, ku 60 % te buxhetit ose ne vlere absolute prej 18 017 561 leke e perben zeri paga dhe sigurime shoqerore te totalit te shpenzimeve prej rreth 30 194 760 leke, 11% e zene shpenzimet e trajtimit ushqimor dhe te djetave te sportistëve, pjesen tjeter prej 29 % te totalit te shpenzimeve e perbejne shpenzime te tjera operative, si faza pergatitore, uniforma, shpenzime per ilace etj.,

Perdorimi i fondeve konform legjislacionit e ne perputhje me **statusin** e tij, mbetet nje nga sfidat e rendeshishme te funksionimit te KF TOMORRI 1923. Sh. A. Kjo shoqeri e mbylli vitin buxhetor me detyrime te delkaruara ne shumen prej 12 955 461 leke, si me poshte:

❖ Detyrime per Tatime e sigurime per vitin 2012-2015, shuma 8 022 632 leke,



BASHKIA BERAT

- ❖ FSHF shuma 574 433 leke,
- ❖ Detyrime ndaj O.S.Sh.E., shuma 1 361 150 leke
- ❖ Ujesjelles kanalizime, shuma 1 350 806 leke,
- ❖ Detyrime Hotelerie , shuma 150 000 leke
- ❖ Detyrime furnitoresh, shuma 1 496 620 leke.

Keto detyrime do te përfshihen ne plan buxhetin e vitit 2016

PROGRAMI I STREHIMIT DHE MENAXHIMIT TE BANESAVE SOCIALE ME QERA

Pershkrimi i programit. Programi I strehimit qe do te zbatoje bashkia , mbeshtetet ne nenin 24 te Ligjit nr. 9232 date 13.05.2004 “Per programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urbane” i ndryshuar ,ka per qellim ti vije ne ndihme familjeve , ku kryefamiljari eshte grua e ve ose e divorcuar; familjet njeprinderore , qe kane femije ne ngarkim ;Te moshuar qe kane mbushur moshen e pensionit qe nuk perzgjidhen per t’u strehuar ne institucionet publike te perkujdesit shoqeror ;Individet me aftesi te kufizuar , te cilet gezojne statusin e te verberit te grupit te pare , te invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik , te invalidit te punes dhe te invalidit te Luftes Nacionalçlirimtare ;Familjet me shume femije ;Çiftet e reja ne moshe totale deri ne 60 vjeç ;Individet me statusin e jetimit qe nga çasti I daljes nga jetimoret,ose nga qendrat e perkujdesit e deri ne moshen 30 vjeç ;Familjet qe nuk kane perfituar nga ligji nr.7652 date 23.12.1992 “Per privatizimin e banesave shtetere”.

Programi i strehimit per vitin 2016 do te realizohet ne tre drejtime kryesore ;

- 1.Dhenien e kredive te zbutura me 3 % interes , duke aplikuar prane M.ZH.U si zbatuese e ketij projekti.
- 2.Trajtimi me banese me kosto te ulet te 35 familjeve , qe do te strehohen ne pallatin e ndertuar nga Enti Kombetar i Banesave, procedurat e familjeve perfituese do te fillojne ne Janar 2016.
- 3.Vazhdimin e bashkepunimit me Entin Kombetar te Banesave per ndertimin e apartamenteve me kosto te ulet , ku ne kontribojme me truallin dhe rrjetin inxhinierik te objektit , pasi edhe kerkesat per kete projekt jane te shumta nga ana e aplikuesve.
- 3.Subvencionimi i qirase per 22 familje ne nevojte ne pamundesi financiare per te paguar qirane mujore , qe aktualisht jane strehuar ne banesat sociale te bashkise .

Politika e programit. Politika e ketij programi konsiston ne ardhjen ne ndihme te familjeve ne nevojte si nepermjet dhenies se bonusit te strehimit per subvencionin e qerave te familjeve ne nevojte, pjesmarrjes ne projektin “Per subvencionimin e kredive me interesa te zbutura” zbatuar nga M.ZH , si dhe ndertimin e apartamenteve me kosto te ulet ne bashkepunim me Entin Kombetar te Banesave .

Njësitë shpenzuese

- **Bashkia Berat**
- **Enti Kombetar i Banesave**

Objektivat e programit



BASHKIA BERAT

- Menaxhimi i 48 apartamenteve të banesave sociale me qera dhe 8 apartamenteve të dhëna me qira të ndertuara nga Enti Kombetar i Banesave Tiranë.
- Perfshirja në skemë e familjeve që përfitojnë bonus strehimi.
- Perfshirja në skemë e familjeve që përfitojnë nga subvencioni i kredive në interes të zbutur, projekt i zbatuar nga M.P.P.T.

Në lidhje me menaxhimin e banesave sociale me qera administrohen 48 apartamente dhe 8 apartamente të ndertuara nga Enti Kombetar i Banesave. Për mirembajtjen e tyre gjatë vitit 2015 janë konsumuar 29 382 leke dhe gjendja financiare e llogaritur se posaçme të hapur me VKB, deri në datën 10.12.2015 është 169857 leke, gjendja e depozitës 14699019 leke dhe interesi bruto nga depozita për vitin 2015 është në shumën 246514 leke.

Më datën 19.12.2014 kemi shlyer koston e parë të kredive CEB për ndertimin e banesave sociale me qera, në shumën 18700 euro, ky kosto u shlye nga të ardhurat e qerave të ngurtesuara në llogari të posaçme sipas dispozitave në fuqi. Ndërsa koston e dytë është i përbërë nga dy kosto: një pjesë e kostonë në shumën 27000 euro, është shlyer me datë 23.10.2015 nga fondi i bashkisë dhe pjesa tjetër e kostonë në shumën 18700 euro do të shlyhet me datë 19.12.2016 dhe do të shlyhet po nga fondi i bashkisë.

Buxheti bashkisë për vitin 2016 për D.M.P. dhe Strehimit.

1. Kostonë e kredive ndaj CEB-it për banesat sociale në shumën 56171 euro të ndarë në tri kosto:

a- Kostonë e parë shuma 10470.7 euro datë e shlyerjes 25 Qershor 2016 nga fondet e bashkisë ..

b- Kostonë e tretë shuma 18700 euro datë e shlyerjes 19 Dhjetor 2016 nga fondet e bashkisë .

2. Subvencionimi i masës së qirave për 22 familjet e strehuara në banesat sociale në shumën 1200000 (njemiljon e dyqind mijë) leke, do të përballohet nga fondi i bashkisë.

3. Rrjeti inxhinierik për pallatin 7 katesh që po nderton E.K.B në shumën 3000000 (tremilion) leke, mbështetur në pikën 2 të nenit 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me M.Z.H.U “Mbi zbatimin e programit për banesat me kosto të ulët” .

Buxheti për banesat sociale për vitin 2016 do të jetë :

1. Shpenzimet për mirembajtjen në vlerën 400 000 (treqind mijë) leke, kjo shumë do të përballohet nga fondi i banesave sociale .

2. Kostonë e dytë për shlyerjen e kredive ndaj CEB-it shuma 27000 euro datë e shlyerjes 23 Tetor 2016 nga fondet e banesave sociale

PROGRAMI I KUJDESIT SOCIAL

a. Trajtimi financiar i personave me aftësi të kufizuara, me ndihmë ekonomike si dhe “Raste të vecanta”

Pershkrimi i Programit. Ky program ka për qëllim të vijë në ndihmë personave me aftësi të kufizuara, trajtuesve të ndihmes ekonomike si dhe të përfshijë në skemën e ndihmes ekonomike familjet të cilat nuk përmbushin kriteret për të përfituar nga legjislacioni në fuqi. Pasi gjykohen arsyet pse familja nuk mund të përfshihet në skemë dhe pasi bëhet verifikimi i gjendjes social-ekonomike të familjes drejtoria e shërbimeve sociale vendos nëse familja mund të trajtohet si rast i vecantë dhe të mbështetet nga fondet e bashkisë.

**Politika e programit.**

Trajtimi i familjeve ne nevoje me ndihme ekonomike, pagesa e paaftesise per personat me aftesi te kufizuar (me fonde te buxhetit te shtetit) si dhe trajtimin si “raste te vecanta”, qe do te mundesoje vleresimin financiar te ketyre familjeve (me fondet e bashkise) duke kontribuar ne rritjen e te ardhurave te familjes.

Objektivat e programit.

Perfshirja ne skeme e individeve/grupeve te percaktuara me ligj si dhe trajtimi si “Raste te vecanta” e individeve/grupeve te perjashtuara nga ligji.

Produktet u realizuan: Numri i familjeve në skemën e ndihmes ekonomike qe trajtohen me fondet e buxhetit te shtetit jane mesatarisht 873 trajtues per vitin 2015 (muaji i fundit rezulton me 660 familje te trajtuara) , Ndarja e re territoriale e zgjeri bashkine berat edhe me 4Njesi Administrative si Sinje, Otlak, Velabisht e Roshnik, Trajtuesit e ndihmes ekonomike per vitin 2015 te ndare sipas Njesive Administrative eshte Berat 700,Otlak 74,Sinje 60,Roshnik 24, Velabisht 15 familje Nga keto jane trajtuar me ndihme te plote 713 familje, me ndihme te pjesshme 160 familje. Perfitues nga skema e ndihmes ekonomike jane 50 familje te komunitetit rom.Kane perfituar ndihme ekonomike 10 familje qe kane ne perberjen e tyre persona me aftesi te kufizuara (PAK). Nga fondet e buxhetit te bashkise jane trajtuar : 17 familje si raste te vecanta me nje fond 690 mije leke , te cilat u perkasin grupeve me vulnerable qe nuk permbushin kriteret per te perfituar nga ligji i ndihmes ekonomike. Persa i takon mases se ndihmes ekonomike eshte mjaft e ulet, keshtu nje familje perfiton mesatarisht ne muaj 4379 leke, sasi e pamjaftueshme per te perballuar nevojat minimale. Gjate vitit 2015 bashkia ka trajtuar me fonde te Buxhetit 2985 persona me aftesi te kufizuara. (PAK).

a. Funksionimi i Qendrave Rezidenciale

Pershkrimi i programit. Ne bashkine Berat funksionojne 2 qendra rezidenciale per persona me aftesi te kufizuar dhe qender ditore me 45 kliente rezident e 20 femije ditor. Qendra “Une jam si Ju” qe trajtohet financiarisht nga fonde te buxhetit te shtetit, dhe “Lira” qe trajtohet financiarisht nga Transferta e pakushtezuar, qe I akordohet bashkise sipas ligjit te buxhetit. Ne keto qendra ofrohen sherbime per riaftesimin fizik, psikik dhe edukativ te klienteve.

Politika e programit .Ngjitja e kapaciteteve per te perballuar kerkesat. Rritja e sherbimeve dhe kualifikimi i punonjesve qe u sherbejne personave te paaft te kliente te qendrave.Rikonstruksione te ndertesave ekzistuese.

Njësitë shpenzuese

- Bashkia Berat
- Buxheti i shtetit
- Donatore



BASHKIA BERAT

Qendra “Lira”.Ka funksionuar per vitin 2015 me nje presonel prej 18 punonjesish me objekt ofrimin e sherbimeve per riaftesimin fizik, psikik dhe edukativ te PAK.

Pasqyra nr. 22

Realizimi i shpenzimeve per Qendren “Lira”

në 000/lek

Emertimi i shpenzimit	Plani 2015	Fakti 2015	Realizimi ne %
Paga	10,112	8,718	86
Sigurime shoqerore	1,656	1,465	88
Shpenzime operative	4,800	4,800	100
Totali i shpenzimeve	16,568	14,983	90

Shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 90 %, mosrealizimi ne masen 1 585 000 leke, kundrejt realizimit 78% me vitin 2013.

Zeri **paga** dhe **sigurime shoqerore** eshte realizuar ne masen 86 %, dhe **88%** duke mos krijuar deficit. Dhe duke paguar ne kohe detyrimet per sigurime shoqerore e shendetsore. Sic shihet mosrealizimi I shpenzimeve eshte I gjithe nga zeri paga dhe sigurime I cili vjen si pasoje e vendeve vakante dhe mosperdorimit te fondit te vecante per shperblime.

Zeri shpenzime operative eshte realizuar ne masen 100%

Qendra “Lira” mbyll vitin buxhetor pa detyrime.

Objektivat e programit;

- Sherbimet e ofruara per klientet kane per qellim riaftesimin psiko- socio-edukativ te standartizuar, per nje jetese te pavarur ose autonome per personat me aftesi te kufizuar mendore e fizike.
- Sherbimin ortofonik dhe logopedik qe synon permiresimin e komunikimit te klienteve
- Sherbimi i fizioterapise per riaftesimin psiko-motor te klienteve me aftesi te kufizuar fizike.
- Sherbimi i ergoterapise nepermjet mini-projekteve te organizuara nga edukatoret dhe klientet e Qendres.
- Sherbimi mjekesor nepermjet mjekut me part-time dhe infermierit me kohe te plote.
- Sherbimi administrative nepermjet personelit ndihmes.

INVESTIMET PUBLIKE

Investimet e perfutuara ne bashkine Berat (te prokuruar nga bashkia) gjate vitit 2015, u financuan nga:

- i. Te ardhurat e bashkise ne shumen 60 000 000 leke ose 32 % te totalit te investimeve.



BASHKIA BERAT

- ii. Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne infrastrukture ne shumen 100 000 000 leke ose 52.5 % te totalit te investimeve.
- iii. Investime nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve ne Arsim ne shumen 29 881 672 leke ose 15.5 % te totalit te investimeve.

Gjate vitit 2015 ne zbatim te buxhetit te miratuar me VKB si dhe fondet e akorduar nga Fonde per Zhvillimin e Rajoneve , jane realizuar procedurat e prokurimit elektronik ne vleren prej **493,360,129** leke nga te cilat:

1. pune civile 477,016,334 leke Pa tvsh (fonde te investimeve)nga ku :
 - pune civile te perfunduara 318,354,980 leke pa tvsh
 - Pune civile ne proces prokurimi 158,661,354 leke pa tvsh
2. Furnizime 16,343,795 leke pa tvsh (furnizime me ushqime, kopshte, cerdhe, konvikte, blerje karburanti)
 - Furnizime te perfunduara 11,685,463 leke pa tvsh
 - Furnizime ne proces prokurimi 4 658 332 leke pa tvsh

a. Investimet nga **burime te veta** per vitin 2015 u planifikuan ne shumen 123,356,000 leke, ose 22.5% e buxhetit ne total , shifer kjo e konsiderueshme ne raport me vitin 2014, dhe ne fakt u realizua 60,000,000 leke.

Investime te programuara e te realizuara per vitin 2015 nga Burime te veta paraqiten sipas pasqyres se meposhtme.

Grupi 00 (teprica neto operative, te ardhurat e Bashkise)					
INVESTIME NE PROCES NGA VITI 2014				11,843	11,843
Prog	Kap	Art	Emertimi	Plan Buxheti	Totali
4530	5	231	Rehabilitim I hapesires urbane L. M. Celebiu	11,616	11616
4530	5	231	Mbikqyrje punimesh Rehab. Haps. Urbane L. M. Celebiu	227	227
INVESTIMET E VITIT 2015				111,513	51,205
Prog	Kap	Art	Emertimi	Plan Buxheti	Totali
4530	5	231	Instituti I Ndertimit, Akt ekspertize	200	200
4530	5	231	Projekt I objektit "Rik. Bibl. V. Buharaja" DEA Studio	942	942
1110	5	231	Pajisje per aparatin e bashkise	17,194	745
4530	5	231	Shpronesim per interes publik	8,863	2,830
4530	5	231	Rehabilitim I hapesirave urbane L. "Murat Celebiu"	5,648	5,648
4530	5	231	Kolaudim "Rehabilitim I haps urbane L. M. Celebiu"	7	7
4530	5	231	Rikonstruksion I trot. Antipatrea Bashki-Gjykate	6,277	1,745
4530	5	231	Supervizim "Rikonstr. I trot Antipatrea Bashki-Gjykate"	86	



BASHKIA BERAT

6260	5	231	Ndertim Lulishte ne lagjen D. Kastrioti	1,663	1,663
4530	5	231	Supervizim "Ndertim lulishte ne Lagjen D.Kastrioti"	46	46
4530	5	231	Kolaudim "Ndertim lulishte ne Lagjen D.Kastrioti"	2	2
4530	5	231	Rikualif. dhe rikonst. I haps. Urbane L. Barrikade	6,172	5,928
4530	5	231	Supervizim "Rik I Haps Urbane Ne L Barrikade"	17	
4530	5	231	Rikualif dhe rikonstr. I rugeve ne L. D. Kastrioti	4,534	4,354
4530	5	231	Supervizim "Rik. I rugeve ne lagjen D. Kastrioti"	18	
10140	5	231	Rikonstruksion I Cerdhes Nr. 1	9,000	12,658
4530	5	231	Supervizim "Rikonstruksion I Cerdhes Nr. 1"	54	54
4530	5	231	Kolaudim "Rikonstruksion I Cerdhes Nr. 1"	1	
4530	5	231	Perforcim I themeleve te palestres se shk. 28 Nentori	612	612
4530	5	231	Supervizim "Perf. I themeleve te palest. shk 22 Tetori	12	12
4530	5	231	Kolaudim "Perf. I themeleve te palest. shk 22 Tetori	1	1
4530	5	231	Supervizim punimesh "Shetitore Osumi"	350	350
4530	5	231	Supervizim "Rik.Shkolla K.Capo"	89	89
4530	5	231	Supervizim "Rehab. I fasadave pergj blv.kryesor"	90	90
4530	5	231	Kolaudim "Rehab. I fasadave pergj blv.kryesor"	48	
4530	5	231	Supervizim "Rik Trot.,Parmak,Ndric. Ura e Varur-Ura e Gorices	115	
4530	5	231	Supervizim "Rik.te parkut D.e Kombit"	180	
4530	5	231	Supervizim "Ndertim I kullës së sahatit"	48	
4530	5	231	Superv. Rik. I lulishtes perend. Lot Ops. dhe sh. T. Muzaka	65	
4530	5	231	Kolaudim "Rikonstruksion I Bulevardit Osumi"	55	55
4530	5	231	Kolaudim I objektit "Rivit. I parkut perendimor te qendres"	114	114
4530	5	231	Kolaudim "Rivit. I shet. Republika Sh. T. Muzaka"	48	48
4530	5	231	Restaurim I murit te Kalase	2,994	1,141
4530	5	231	Supervizim I obj. Restuarim I murit te kalase	77	
4530	5	231	Kolaudim I obj. Restuarim I murit te kalase	10	5
4530	5	231	Supervizim Punimesh "Rikonstr. I shk. Th Tani"	101	33
4530	5	231	Supervizim Punimesh "Ndertim I fushave sportive"	99	32
4530	5	231	Shlyerje kredise se Banesave sociale	6,398	3,783
4530	5	231	Detyrim per bashkep. me Fondin Shqiptar te Zhvillimit	1,964	
4530	5	231	Supervizim Rikonstruksioni I Biblkiotekes	180	
4530	5	231	Kolaudim Rikonstruksion I shkolles "Kristaq Capo"	35	35
4530	5	231	Kolaudime e supervizime	32,594	5,680
6260	5	231	Investime pajisje per Ndermarrjen e Gjelberimit	120	120
4530	5	231	Investime per NRRT Ndricimit Publik dhe Dekorit	700	700
8250	5	231	Investime Qendra Kulturore	1,980	1273
9120	5	231	Investime Qendra Ekonomike e Arsimit	1,710	210
			Totali i investimeve nga te ardhurat e Bashkise	123,356	63,048



BASHKIA BERAT

Pasqyra nr. 23


Investimet nga Grandet Konkurruese (Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve) ne vite

në 000/lek

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Vlera	14,908	67,696	29,568	72,218	19,334	0	197,350	108,630

Grafiku nr. 14

Investimet nga Grandet Konkurruese ne dinamike ne vite



Pasqyra nr.24

Investimet nga Komiteti i Zhvillimit te Rajoneve per vitin 2015.

INVESTIME NE INFRASTRUKTURE					
Prog	Kap	Art	Emertimi dhe vlere e plote e projektit	Plan	Totali
4530	1	231	Rivitalizim I parkut perendimor te qendres	2,337	2,337
4530	1	231	Rikonstruksion i Shetitores Osumi	5,944	5,944
4530	1	231	Rik. Lulishte perend., Sh. T.Muzaka, loti opsional	5,992	5,992
4530	1	231	Rehabilitim I fasadave pergjate bulevardit kryesor	35,100	35,072
4530	1	231	Ndertim I Kulles se Sahatit	4,998	-
4530	1	231	Rikonstr. I trot., parmak. Ura e Varur-Ura e Gorices	5,920	5,920
4530	1	231	Rikualif. dhe rikonst. I parkut "D. e Kombit", trotuareve	56,950	46,899
4530	1	231	Rikonstruksion I biblioteke "Vehxhi Buharaja"	24,500	24,500
			Totali i investimeve ne infrastrukture	180,301	180,301
INVESTIME NE ARSIM					
Prog	Kap	Art	Emertimi dhe vlere e plote e projektit	Plan	Totali
9230	1	231	Rikonstruksion I shkolles se mesme "K. Capo"	14,229	14,229
9120	1	231	Rikonst.Shkolla "Thimi Tani"	12,914	12,914
9120	1	231	Fusha sportive shkolla "A. Xhindole", "28 Nentori", "Xh. Cekini"	2,740	2,740
			Totali i investimeve ne arsim	29 883	29,883



A. Auditimi- instrument I rendesishem per zbatimin e ligjshmerise.....

Struktura e Auditimit te Brendshem e Bashkise Berat duke qene ne krah te titullarit po shihet gjithnje e me shume si një instrument për rritjen e performancës se njesive te audituara.

Në mënyrë të vazhdueshme, auditimi ka qenë dhe është një mekanizëm,i cili siguron menaxhimin e larte per funksionimin e kontrollit te brendshem dhe minimizimin e mundesive per mashtrim e shperdorim te fondeve buxhetore.

Gjithe puna e auditimit per te arritur permbushjen me sukses te misionit dhe objektivave kryhet nepermjet planifikimit, kontrollit, punes ne terren dhe ndjekes se rekomandimeve ne njesite e planifikuara per auditim.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm e fokusuar në vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes jep siguri të arsyeshme nëse:

- ✚ Objektivat kryesorë të përcaktuara në programet dhe planet e subjekteve do të arrihen;
- ✚ Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri
- ✚ Veprimtaria e subjekteve është në përputhshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe aktet nënligjore;
- ✚ Informacionet e rëndësishme financiare janë të sakta,të besueshme dhe në kohën e duhur;
- ✚ Rekomandimet janë dhënë në mënyrë objektive dhe në kohë.

Eshte pergjegjesi e punonjesve te auditit te studiojne mjedisin dhe fushat me risk te njesive qe do te auditohen,ne menyre qe te ushtrohet kontroll me i madh ndaj njesive qe jane me te ekspozuara ndaj riskut, ndaj njesive qe menaxhojne fonde me te medha, ndaj njesive qe kryejne nje volum shume te madh te veprimeve financiare,ndaj njesive qe kane probabilitetin me te madh per shperdorim te fondeve.

Mbi kete gjykim njesia e auditimit percakton planin vjetor dhe strategjik per kryerjen e angazhimit te auditimit te miratuar nga titullari i institucionit.

Sistemet dhe fushat që auditimi i brendshëm ka vlerësuar me një nivel të lartë dhe te mesem risku gjenden kryesisht ne sistemet e menaxhimit financiar, ne menaxhimin e aseteteve, ne sistemin e prokurimit publik, ne sistemin e perputhshmerise se dokumentacionit me bazen ligjore rrjedhoje kjo e mosazhornimit ne kohe me te rejat e fundit ne legjislacion.

Nevojitet të përmendet se, shkalla e zbatimit të rekomandimeve duhet te permiresohet edhe me teper ndaj procesi i zbatimit të tyre ne te ardhmen do te ndiqet me me prioritete nga njesia e Auditit te Brendshem nepermjet kontrolleve te here pas hershme dhe ushtrimit te kompetencave te auditit per te gjetur zgjidhje.

Gjate vitit 2015 jane audituar te gjitha njesite shpenzuese ne varesi te Bashkise Berat sikurse edhe disa drejtori brenda strukturese Bashkise Berat.

Jane realizuar gjithsej 16 angazhime auditimi, jane dhene 66 rekomandime dhe jane lene 6 masa zhdemtimi ne vleren 115'292, dhe ndalesa page ne vleren 45'927 leke.

Ne proces auditimi jane Drejtoria e Menaxhimit te Pronave te Bashkise dhe Banesave Sociale si edhe Drejtoria e Taksave dhe Tregjeve



BASHKIA BERAT

Nga auditimet konstatojme se veprimtaria ekonomike-financiare e njesive te audituara nga viti ne vit ka permiresim te menaxhimit te fondeve, uljen e rasteve te shkeljeve, dhe nje shprehje te vullnetit te njesive shpenzuese per te kryer cdo pune apo sherbim ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Eshte me rendesi te madhe qe cdo njesi shpenzuese mbeshtetur mbi objektivat e saj te matshme e te arritshme te hartoje rregjistrin e riskut ne menyre qe t'i paraprije gabimeve apo ngjarjeve te ndryshme qe mund te cojne ne dem ekonomik te njesise, ndaj dhe puna e grupit te auditit te bashkise do te fokusohet ne menyren si keto njesi punojne per arritjen e objektivave, sa fleksible jane per te zgjidhur problemet e ndryshme financiare etj.

Ne Vitin e Ri financiar njesia e auditimit synon nje performance ne rritje dhe profesionalizem per te thelluar me tej auditimin mbi perdorimin e fondeve buxhetore duke minimizuar mundësitë për mashtrim, shpërdorim , abuzim dhe keqperdorim.



PLAN BUXHETI I VITIT 2016

Përmbledhje e propozimeve të buxhetit të vitit 2016 me ndikim në qeverisjen vendore.

- ✓ Viti 2016 shënon një tjetër moment historik të decentralizimit dhe të autonomisë së pushtetit vendor. Zgjedhjet vendore të vitit 2015, shënuan fillimin e qeverisjes vendore sipas ndarjes së re administrativo-territoriale.

Transferta e pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2016 parashikohet në nivelin 14.3 miliardë lek ose rreth 16% më shumë se në vitin 2015.

➤ **Kjo shumë përfshin fondin prej 1.16 miliard lek për:**

(i) konviktet,

(ii) qendrat sociale

(iii) dhe rrugët rurale;

- fondin prej 1.3 miliard lekë që qeveria ka vënë në dispozicion të njësive vendore për të kompensuar heqjen e taksës së biznesit të vogël si dhe;
- fondin rezervë prej 100 milion lek për t'u shpërndarë gjatë vitit fiskal për korrigjime të efekteve të formulës dhe financimit të funksioneve të reja.
- Transferta për vitin 2016 ndahet sipas një formule të re të hartuar me kontributin e projektit të Planifikimit dhe Qeverisjes Vendore të financuar nga USAID, e cila bazohet në:

- b. të dhënat e popullsisë,
- c. dendësinë e popullsisë
- d. numrit të nxënësve në shkolla.
- e. Në formulë parashikohet një harmonizim i të dhënave të popullsisë sipas Census-it dhe Gjendjes Civile, si dhe një ekualizim fiskal duke kompensuar njësitë me dendësi të popullsisë dhe kapacitet fiskal më të ulët.
- f. Një tjetër risi e projektbuxhetit për vitin 2016 është detyrimi i Bashkive për të përdorur jo **më pak se 40% të transfertës së pakushtëzuar për investime.**
- g. Në lidhje me paketën fiskale të vitit 2016, ndryshime të rëndësishme lidhen me taksën e pasurisë, ku Qeveria propozon vendosjen e taksës mbi truallin (jo-hapësirë publike) dhe detyrimin për përdoruesin e pasurisë së paluajtshme për të vetëdeklaruar sipërfaqen e pasurisë dhe për të paguar taksën.
- h. Nje ndryshim lidhet me përjashtimin nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin i Bizneseve të Vogla me qarkullim vjetor 0-5 milionë lek
- i. uljen e shkallës tatimore nga 7,5 % në 5 % të këtij tatimi për ato me qarkullim vjetor 5-8 milion lek.
- j. Efekti financiar i kësaj politike vlerësohet në rreth 1.3 miliardë lek, të cilat i janë shtuar transfertës së pakushtëzuar, e për rrjedhojë ndahen nëpërmjet formulës.
- k. Kjo politike rezulton në ulje të ardhurash për Bashkitë.
- l. Gjithashtu edhe taksa vendore për fjetjen në hotel propozohet të reduktohet nga 5% e çmimit të fjetjes që është aktualisht, në nivelin 140 lek për person/për natë qëndrimi.
- m. Në relacionin shoqërues të projekt-buxhetit, Qeveria përcakton përmirësimin e administrimit të taksave vendore, nga Bashkitë e reja të organizuara pas reformës administrative, si burimin kryesor për gjenerimin e të ardhurave të veta.



BASHKIA BERAT

- n.** Përsa i përket funksioneve të reja që u transferohen njërive të qeverisjes vendore, ato do të financohen nëpërmjet **transfertave specifike për çdo funksion dhe për çdo njësi.**
- o.** Fondet për funksionet e lidhura me bujqësinë, ujitjen dhe kullimin ende nuk janë përcaktuar, dhe pritjet që brenda muajit janar 2016, Këshilli i Ministrave të miratojë fondet që do transferohen nga Ministria e Bujqësisë tek Bashkitë si dhe të ndajë ndërmjet 61 Bashkive, fondin prej rreth 2.5 miliard lekë për investimet e nevojshme në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit.
- p.** Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2016, parashikohet në nivelin 10 miliardë lekë, dhe do të përdoret për financimin e tre shtyllave kryesore:
 - A.** programi i zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale vendore,
 - B.** programi Shqipëria dixhitale
 - C.** një program i ri që parashikohet të mbështesë ekonominë vendore.
- D.** Risi të tjera të rëndësishme lidhen me krijimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Rajoneve dhe katër Agjencive të tjera për Zhvillimin e Rajoneve që do të operojnë në nivel rajonal. Gjithashtu, për dy shtyllat e Mbështetjes së Ekonomisë dhe “Shqipëria Dixhitale”, përveç Bashkive, për herë të parë parashikohet mundësia e financimit të skemave të granteve me përfitues individë dhe subjekte private
- ✓ Ndarja e re administrativo-territoriale, do të pasohet nga një reformë tjetër e decentralizimit fiskal. Me këto reforma synohet:
 - (v) demokratizimi i qeverisjes;
 - (vi) efienca në ofrimin e shërbimeve për qytetarët;
 - (vii) zhvillimi ekonomik lokal,
 - (viii) zhdukja e pabarazive dhe zhvillimi i qëndrueshëm.
- ✓ Janë bërë disa përmirësime të tjera cilësore në formulën ndarjes së transfertës së pakushtëzuar për njësitë e qeverisjes vendore. Janë vendosur kritere dhe tavane që garantojnë funksionimin normal të të gjitha njësive të qeverisjes vendore.
- ✓ Për vitin 2016, transferta e pakushtëzuar do të ndahet në 61 NJQV, sipas kritereve të mësipërme, por duke rifreskuar të dhënat për popullsinë, kapacitetet fiskale dhe tregues të tjerë të varfërisë.
- ✓ Buxhetit vjetor të vitit 2016 I shtohet dhe transferta specifike për financimin e funksioneve të reja që I shtohen bashkive. (të shprehura në mesazhin e kryetarit të Bashkive për buxhetin).
- ✓ Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, i provuar si një skemë financimi e suksesshme merr rëndësi akoma më të madhe në buxhetin e vitit 2016. Objektivat më të mëdha të qeverisë për rilindjen e qyteteve dhe të qendrave të tjera zhvillimore, gjejnë mbështetjen e plotë në skemën e financimit të investimeve nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve.
- ✓ Rritja e konsiderueshme e fondit në këtë skemë bën që buxheti vendor të jetë më i madhi në historinë e tij.

Buxheti vendor i vitit 2016, me tërë komponentët e tij (transfertë e pakushtëzuar, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, renta minerare dhe të ardhurat e veta).

Në këndvështrimin makroekonomik, buxheti 2016 ben te mundur



BASHKIA BERAT

- Rritjen reale ekonomike nga 2.7 % te PBB-se per vitin 2015 në 3.4% te PBB-se në vitin në vitin 2016.
- Mbajtjen e nje niveli prej 5% te PBB-se per investimet publike
- Vazhdimin e reformave strukture thelbesisht te domosdoshme per te ardhmen afatmesem dhe afatgjate te ekonomise ne fushat e energjise, konsolidimit territorial te 61 bashkive, tregut te punes, administrates publike, kunder informalitetit dhe evazionit fiskal, drejtesise dhe punesimit etj.

Niveli I parashikuar I inflacionit eshte 2.3% per vitin 2016, 2.7% per vitin 2017 dhe 3% per vitin 2018.

Deficiti I pergjithshem fiskal I targetuar ne buxhetin e vitit 2016 eshte 2.2%, niveli me I ulet pergjate me shume se dy dekadave te fundit. Krahasuar me vitin 2015 niveli I deficitit I programuar per vitin 2016 shenon nje ulje me 40%.

Per vitin 2016 eshte programuar nje suficit prej 2.9% te PBB-se, qe do te thote se eshte programuar nje huamarrje totale neto relativisht minimale ne 2.2% te PBB-sedhe nje nivel relativisht I larte I investimeve publike totale ne 5.1% te PBB-se(perfshire ketu edhe FZHR dhe investimet ne sektorin energjistik te fianncuar nga buxheti)

Konsolidimi fiskal dhe reduktimi I borxhit public parashikohen si thelbesor ne uljen e risqeve te ardhura nga borxhi dhe qe pengojne rritjen ekonomike.

Niveli I parashikuar I inflacionit eshte 2.3% per vitin 2016, 2.7% per vitin 2017 dhe 3% per vitin 2018.

Deficiti I pergjithshem fiskal I targetuar ne buxhetin e vitit 2016 eshte 2.2%, niveli me I ulet pergjate me shume se dy dekadave te fundit. Krahasuar me vitin 2015 niveli I deficitit I programuar per vitin 2016 shenon nje ulje me 40%.

Per vitin 2016 eshte programuar nje suficit prej 2.9% te PBB-se, qe do te thote se eshte programuar nje huamarrje totale neto relativisht minimale ne 2.2% te PBB-sedhe nje nivel relativisht I larte I investimeve publike totale ne 5.1% te PBB-se(perfshire ketu edhe FZHR dhe investimet ne sektorin energjistik te fianncuar nga buxheti)

Konsolidimi fiskal dhe reduktimi I borxhit public parashikohen si thelbesor ne uljen e risqeve te ardhura nga borxhi dhe qe pengojne rritjen ekonomike.

1. Struktura financiare e buxhetit 2016

Hartimi i planbuxhetit vjetor eshte i mbeshtetur ne ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise” ne Udhhezimin e Ministrise se Finances 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Ligjit “Per buxhetin e vitit 2016”, miratuar ne Parlament me daten 17.12.2015.

Plan buxheti i **vitet 2016 eshte i balancuar**. Ne mbeshtetje te Udhhezimit te Ministrit te financave nr.2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” buxheti vendor eshte unik, te ardhurat dhe shpenzimet parashikohem per cdo ze te tyre, pavaresisht nga burimet e financimit.




BASHKIA BERAT

Struktura e tij eshte e plote, per te gjithë elementet, si ne krahun e te ardhurave dhe ne ate te shpenzimeve.

Mbeshtetur ne pervojen e viteve te meparshme, ky buxhet eshte i detajuar deri ne llogarite analitike, per cdo ze te ardhure dhe shpenzimi.

Miratimi i shpenzimeve paraqitet ne nivel programi.



Plan buxheti i vitit 2016 perbehet nga :

Te dhenat ne /000 leke

A - Te ardhurat gjithsej (I +II).....762 622

I - Te ardhurat e buxhetit te pavarur.....330 000

- Te ardhurat Lokale (Plan i vitit 2015).....330 000

II - Transferta gjithsej.....432 622

- Transferta e pa kushtezuar219 580

- Transferta specifike.....213 042

B - Shpenzimet gjithsej 762 622

I-shpenzime operative.....448 680

II-Shpenzime per funks spec. te deleguara.....213 041

III - Investime gjithsej (Teprica neto operative)100 900

Nga te ardhurat e Bashkise100 900



1.1 TË ARDHURA NGA BURIME KOMBETARE

Njësitë e qeverisjes vendore financohen nga këto burime kombëtare:

1. Transferta e Pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit.

Transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit është e ardhur për njësitë e qeverisjes vendore, e përfituar në formën e dhurimit pa kusht kthimi, pa interes, e cila përdoret për financimin e shpenzimeve për funksionet e veta dhe të përbashkëta të njësive të qeverisjes vendore, të përcaktuara në ligjin Nr. 8652, datë 31. 07. 2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2016 për Bashkinë Berat është 219 580 000 *leke*.

Transferta specifike për vitin 2015 për Bashkinë Berat në total është 206 582 000 *leke*.

Transferta e pakushtëzuar në vitin 2014 për Bashkinë Berat ishte 196 289 000 *leke*.

Përsa i përket funksioneve të reja që u transferohen njësive të qeverisjes vendore, ato do të financohen nëpërmjet **transfertave specifike për çdo funksion dhe për çdo njësi**.

Financimet që do të merren për këto funksione janë:

1. Qendrat e shërbimeve sociale;
2. Shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;
3. Personelin mësimor dhe jo-mësimor në arsimin parashkollor;
4. Personelin jo-mësimor në arsimin parauniversitar;
5. Konviktet e arsimit parauniversitar;
6. Rrugët rurale;
7. Administrimin e shërbimit pyjor;
8. Ujitja dhe Kullimi.

Fondet për zhvillimin e rajoneve. Në bazë të Aneksit Nr. 3 të ligjit “Për buxhetin e vitit 2016”, për shpërndarjen e fondeve të rajoneve ngrihet komiteti i vlerësimit dhe miratimit të projekteve.

Aplikimi për fonde bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke i dërguar projektet në:

- Fondin Shqiptar të Zhvillimit për objektet e infrastrukturës vendore.
- Ministrinë e Arsimit dhe sporteve për objektet arsimore.
- Ministrinë e Shëndetësisë për objektet shëndetësore.
- Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për objektet ndërtim tregjesh agro-ushqimorë, thertoresh dhe objekte për ujitje/kullim.
- Ministrinë e Kulturës, për objektet kulturore.
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.



2. **Transferta të Kushtëzuara për funksione të deleguara.**

Transferta e kushtëzuara në buxhetin e vitit 2016, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara (Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për QKR, dhe shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të gjëndjes civile. Këto fonde do të përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë dhe në përputhje me rregullat e caktuara nga pushteti qëndror. Njësitë e qeverisjes vendore nuk mund të përdorin për qëllime të tjera, përveç atyre të përcaktuara.

Per buxhetin e vitit 2016 transfera të kushtëzuara që do akordohet për Bashkinë Berat do konfirmohet nga Ministritë e linjës gjatë vitit 2016.

3. **Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.**

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së Mireqenies Sociale dhe të Rinisë, pra përfshihen në buxhetin e kësaj Ministrie. Ato ju delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmës ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore. Per buxhetin e vitit 2016 transfera të kushtëzuara që do akordohet për Bashkinë Berat, do konfirmohet nga Ministritë e linjës gjatë vitit 2016.

A. **PLANI I TË ARDHURAVE**

a. **Te ardhurat lokale**

Pranë Bashkisë Berat në kuadër të hartimit të planit të të ardhurave, pjesë përbërëse e Buxhetit të vitit 2016, është ngritur Grupi për Strategji Buxhet dhe Integritim.

Si çdo vit planifikimi i të ardhurave të vitit 2016 është kryer në mënyrë analitike, duke ju referuar cdo takse dhe tarife vendore, të cilat analizohen në hollësi. Cdo e ardhur është planifikuar në bashkëpunim me punonjësit të cilët kanë lidhje të drejtpërdrejtë në punën e tyre me arkëtimet nga taksat dhe tarifat vendore. Këtu bën pjesë gjithë stafi i Drejtorisë së Taksave Regjistrimit të Biznesit dhe Tregjeve, stafi njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Otlak, Velabisht ashtu edhe stafi i Drejtorive të tjera të Bashkisë Berat.

Viti 2016 është viti i parë që planifikojmë të ardhurat e Bashkisë “së madhe” Berat në të cilën përfshihet një territor më i gjërë. Natyrisht që një planifikim i tillë paraqet shumë vështirësi kjo për faktin se 4 njësitë administrative kanë burime financiare tepër të kufizuara.

Gjithashtu paraqet shumë vështirësi mbulimi i shpenzimeve të këtyre njësitë me të ardhurat që ato vetë do realizojnë. Si rrjedhojë shpenzimet e tyre do mbulohen nga të ardhurat që do sigurojë Bashkia Qëndër.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2016 mbështetet kryesisht në :

- Reflektimin e politikave fiskale të aplikuara gjatë vitit 2015, me ndryshimet përkatëse.
- Ruajtjen e qëndrueshmërisë të nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve.
- Realizimin faktik të ardhurave të vitit 2015.



BASHKIA BERAT

- Parashikimin e të ardhurave nga agjentët tatimorë,
- Thellimin e vazhdueshëm të punës në drejtim të evidentimit dhe regjistrimit të subjekteve të peregjistruar në organet tatimore.

Për vitin 2016 të ardhurat totale pashikohen në shumën 549,580,000 leke. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të ardhurat nga legalizimet si dhe të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar sipas tabelës së mëposhtme :

Emertimi	I pritshmi 2015	Plan 2016
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore	238,164,000	324,000,000
Të ardhurat e trashëguara	41,993,000	-
Të ardhurat nga legalizimet	985,000	6,000,000
Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuar	235,595,000	219,580,000
TOTALI	516,737,000	549,580,000

RISITË DHE RISQET QË PRITEN TË NA SHOQËROJNË GJATË VITIT TË ARDHSHEM 2016 TË CILAT DO TË NDIKOJNË TË ARDHURAT E BASHKISË

RISITË :

- Permiresimi i shërbimit ndaj tatimpaguesve si rrjedhojë e shtrirjes në njësitë administrative dhe zyrat e taksave ku paguhen taksat e familjes të sistemit bashkëkohor informatik tatimor TAIS për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Kjo do të sjellë uljen e kohës së shërbimit ndaj tatimpaguesve dhe ulje të punës manuale të specialistëve.
- Në kuadër të reformës territoriale zgjerimi i vijës administrative të Bashkisë do të rrisë potencialin e të ardhurave të Bashkisë Berat, por do të kërkojë edhe rritje të strukturës së administratës tatimore vendore.
- Ulet taksa për ndërtesat që përdoren për veprimtari prodhuese.
- Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i shtohet një komponent, taksa mbi truallin (jo tokë bujqësore) e cila ndahet në dy kategori, sipas përdoruesve të truallit që përdoret për qëllime banimi nga individët dhe për truallin që përdoret për qëllime biznesi.
- Ndryshohet taksa e fjetjes në hotel. Kjo taksë nga 5% e çmimit të fjetjes që ka qënë më përpara vendoset në disa nivele të ndryshme, në përputhje me kategorizimin e bashkisë dhe llojin e njësive akomoduese.
- Takseës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja i bëhet një shtesë, sipas së cilës në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë rritet në masën 4% deri 8% të çmimit të shitjes për metër katror.



BASHKIA BERAT

- Ndryshohet taksa e tabelës. Përkatësisht detajohet dhe riklasifikohet taksa e tabelës për qëllime identifikimi si dhe detajohet, për sa i përket nivelit të taksës, taksa e tabelës për qëllime reklamimi.
- Taksa e zënies së hapësirave publike riklasifikohet si tarifë. Kjo për arsye se zënia e hapësirave publike për qëllime biznesi është qiradhënie dhe jo taksë. Përcaktimi si tarifë do të mundësojë një vendimmarrje më të plotë

RISQET:

- ✓ Pezullimi i dhënies së lejeve të ndërtimit për qytetin e Beratit, në zbatim të vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit të datës 08.10.2013 mund të reflektohet në mosrealizimin e të ardhurave nga ky burim shumë i rëndësishëm për financat vendore.
- ✓ Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ndryshon nivel. Pa dyshim që zerimi i këtij tatimi për subjektet e biznesit me qarkullim vjetor deri në 5 milion lekë, është një nga efektet më negative në kurriz të të ardhurave të Bashkisë Berat. Në këto dy vjet që ky tatim po administrohet nga administrata tatimore qendrore, ky tatim është ndryshuar disa herë. Me ndryshimet më të fundit fiskale ky tatim përvec se hiqet për subjektet me xhiro deri në 5 milion lekë por edhe ulet me ulet me 2.5% nga 7.5% e fitimit të tatueshëm në 5% e fitimit të tatueshëm si dhe për këtë kategori biznesi është hequr pragu minimal i pagesës prej 25,000 lekë/vit.
Në këto kushte, duke pasur parasysh kapacitetet e ulta fiskale të njësive administrative që na bashkohen si dhe për të kompensuar disi efektet nga zerimi i tatimit, detyrohemi që të rrisim tarifën për shërbimet publike të ndriçimit dhe gjelbërimit.

Në total, për vitin 2016, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore janë planifikuar në shumën 330,000,000 lekë. Kundrejt realizimit të pritshëm të vitit 2015 në shumën 239,149,000 lekë të ardhurat e vitit 2016 janë planifikuar +90,851,000 lekë ose +38% më shumë.

Bashkia Qëndër planifikon të arkëtojë 210,691,000 lekë ose 64 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Roshnik planifikon të arkëtojë 6,260,000 lekë ose 2 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Sinjë planifikon të arkëtojë 10,825,000 lekë ose 3 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Otlak planifikon të arkëtojë 24,791,000 lekë ose 8 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Njësia administrative Velabisht planifikon të arkëtojë 13,769,000 lekë ose 4 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.

Nga agentët tatimore planifikohen të arkëtohen 63,664,000 lekë ose 19 % kundrejt planit total të të ardhurave të bashkisë.



BASHKIA BERAT

Tabela e mëposhtme paraqet një informacion mbi planifikimin e të ardhurave të vitit 2016 sipas grupeve kryesore :

Emërtimi	Plani 2016	Në /000 lekë
		Struktura (në %)
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	34,964	11
Të ardhura nga taksat vendore	150,515	45
Të ardhura nga tarifat vendore	103,670	31
Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit	11,800	4
Të ardhura të tjera	23,051	7
Të ardhura nga legalizimet	6,000	2
TOTALI	330,000	100

Peshën kryesore të rritjes së planit të të ardhurave të vitit 2016 në krahasim me realizimin e pritshëm të vitit 2015 e kanë të ardhurat nga taksat vendore në vlerën +61,620,000 lekë, rritje e cila vjen si rrjedhojë e planifikimit të ardhurave për tu realizuar nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe nga taksa mbi token bujqësore siu dhe nga efektet e ndryshimeve në paketën fiskale.

Në pasqyrat e mëposhtme paraqitet analitikisht planifikimi i cdo takse dhe tarife vendore për vitin 2016.

Pasqyra nr. 25

Pasqyra përmbledhëse e planit të të ardhurave të vitit 2016 të Bashkisë Berat në /000 lekë

Nr	Emertimi	Plani 2016
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	34,964
II	Taksat vendore	150,515
1	Takse tabele	3,938
•	Tabelë për qëllime identifikimi	957
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,981
2	Ter ardhura nga zënia e hapsirave publike	15,842
3	Takse ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	30,000
4	Takse fjetje në hotel	1,936
5	Takse mbi token bujqësore	19,069
6	Takse e mjeteve të përdorura	19,700
7	Takse e kalimit të së drejtës së pronësisë	3,000
8	Takse mbi ndertesat	49,579
•	Biznes	41,450
•	Familje	8,129
9	Takse trualli	3,451
10	Te tjera taksa	4,000
III	Tarifat vendore	103,670
1	Tarife e pastrimit	55,056
•	Biznes	37,499



BASHKIA BERAT

•	Familje	17,557
2	Tarife e ndriçimit publik	21,986
•	Biznes	7,463
•	Familje	14,522
3	Tarife gjelberimi publik	10,827
•	Biznes	4,879
•	Familje	5,948
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,445
5	Tarifa urbanistike	300
6	Tarifa te sherbimit administrativ	700
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	1,900
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartelexuesi	275
9	Tarifa te sherbimit te varrimit	6,000
10	Tarife per lende drusore	1,195
11	Tarife uji i pijshem	3,256
12	Takse therje	320
13	Te tjera tarifa	410
IV	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	11,800
1	Te ardhura nga konviktet	1,200
2	Te ardhura nga cerdhet	3,700
3	Te ardhura nga kopshtet	6,900
V	Te ardhura te tjera	23,051
1	Te ardhura nga parkimi	2,551
2	Te ardhura nga qerate	7,529
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	10,111
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	1,000
5	Te ardhura nga biletat	200
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	1,660
VI	Te ardhura nga legalizimet	6,000
TOTALI		330,000

PLANI I TË ARDHURAVE TE NJËSISË ADMINISTRATIVE BERAT

Pasqyra nr. 26

Nr	Emertimi	Plani 2016 (në mijë leke)
I	Taksat vendore	92,424
1	Takse tabele	3,650
•	Tabelë për qëllime identifikimi	905
•	Tabelë për qëllime reklamimi	2,745
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	15,395
3	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	30,000
4	Takse fjetje ne hotel	1,936
5	Takse mbi token bujqesore	1,023



BASHKIA BERAT

6	Takse mbi ndertesat	37,184
•	Biznes	31,581
•	Familje	5,603
7	Takse trualli	3,236
II	Tarifat vendore	91,201
1	Tarife e pastrimit	48,115
•	Biznes	32,650
•	Familje	15,465
2	Tarife e ndriçimit publik	21,739
•	Biznes	7,463
•	Familje	14,275
3	Tarife gjelberimi publik	10,827
•	Biznes	4,879
•	Familje	5,948
4	Tarife regjistrim veprimtarie biznesi	1,345
5	Tarifa urbanistike	300
6	Tarifa te sherbimit administrativ	700
7	Tarife per license/certifikate ne fushen e transportit rrugor	1,900
8	Tarifa per zenien e sallave dhe celje kartelexuesi	275
9	Tarifa te sherbimit te varrimit	6,000
III	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	11,800
1	Te ardhura nga konviktet	1,200
2	Te ardhura nga cerdhet	3,700
3	Te ardhura nga kopshtet	6,900
IV	Te ardhura te tjera	15,266
1	Te ardhura nga parkimi	2,406
2	Te ardhura nga qerate	7,000
3	Te ardhura nga gjobat, k. vonesa etj..	3,000
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	1,000
5	Te ardhura nga biletat	200
6	Te tjera debitore dhe gjyqe	1,660
TOTALI		210,691

PASQYRAT E DETAJUARA TË PLANI I TË ARDHURAVE TE NJËSISË ADMINISTRATIVE BERAT

Pasqyra nr. 27

Pasqyra e planifikimit të të ardhurave nga taksa e tabelës

në /000 lekë

Nr.	Aktiviteti	Niveli takses	Nr. Subjekteve/ sip ne m2	Plani 2016 (në mijë leke)
I. Takse table per qellime identifikimi				905
1	Jashtë territorit ku zhvillohet aktivitet në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim	120	40	5



BASHKIA BERAT

2	Deri në 2 m2, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.	-	1,779	-
3	Mbi 2 m2, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brënda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.	45,000	20	900
II. Takse table per qellime reklamimi				2,745
1	Tabelë e thjeshtë	22,500	122	2,745
2	Tabelë elektronike	45,000	-	-
TOTALI				3,650

Pasqyra nr. 28

Pasqyra e planifikimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme

në /000 lekë

Nr	Grupet e taksë paguesve	Baza e llogaritjes (Sip ne m ² /ha)	Niveli i taksës	Plani 2016 (në mije leke)
I	Taksa mbi ndertesat			37,184
1	Familjet (ndertesa banimi)	659,150 x 85%		5,603
•	Para vitit 1993	394,000 x 85%	10	3,349
